



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i integruar i studimeve të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:

“Drejtësi”

ofruar nga

Universiteti i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


Prof. Dr. Iset Morina

Dr. Dorina Gjipali

Korrik / 2025

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË INTEGRUAR
TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE NË: “DREJTËSI”**

1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Fakulteti i Drejtësisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Programi i integruar i studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në: “Drejtësi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 396, datë 22.07.2019
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	5 Vite akademike / 10 Semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	300 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe / angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	91 PAE / 37 PAK
18	Numri i studentëve:	Viti 2019-2020 651 studentë Viti 2020-2021 653 studentë Viti 2021-2022 674 studentë Viti 2022-2023 652 studentë Viti 2023-2024 674 studentë
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Tiranës (UT) është një institucion publik i arsimit të lartë, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 207, datë 30.05.1957. UT-së i është akorduar akreditimi institucional me Vendim të Bordit të Akreditimit nr. 4, datë 27.01.2023, me kohëzgjatje prej gjashtë viteve akademike dhe afat vlefshmërie deri më 26.01.2029.

Fakulteti i Drejtësisë, si një nga njësitë kryesore të UT-së, ofron Programin e Integruar të Studimeve të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi", në funksion të misionit të tij akademik dhe shkencor për forcimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të vlerave kombëtare në fushën e drejtësisë.

Ky program studimi, i ciklit të dytë, është riorganizuar mbi bazën e programit Bachelor në Drejtësi, me Urdhërin nr. 396, datë 22.07.2019 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë, dhe ofrohet nga tri njësi bazë të Fakultetit:

1. Departamenti i të Drejtës Civile;
2. Departamenti i të Drejtës Penale;
3. Departamenti i të Drejtës Publike;

Programi synon të ofrojë dhe të promovojë vlera akademike dhe shkencore në fushën e drejtësisë. Ai përmban 300 ECTS dhe është i organizuar në pesë vite akademike (10 semestra), duke garantuar përvetësimin e njohurive themelore dhe të avancuara në të gjitha fushat kryesore të së drejtës publike, civile dhe penale.

Ky cikël studimesh u mundëson të diplomuarve vazhdimin e studimeve në ciklin e tretë, si dhe aftësinë për të ndjekur karriera profesionale në drejtësi, përfshirë Shkollën e Magjistraturës, Noterinë, Avokatinë, si dhe punësimin në tregun e punës si ekspertë ligjorë apo punonjës në sektorin publik apo privat.

Programi i Integruar i Ciklit të Dytë të Studimeve "Master i Shkencave" në "Drejtësi" që ofrohet nga Fakulteti i Drejtësisë akreditohet për herë të parë.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e Programit të Integruar të Ciklit të Dytë të Studimeve "Master i Shkencave" në "Drejtësi", i ofruar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, është zhvilluar në përputhje me kërkesat dhe udhëzimet e përcaktuara në "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit".

Procesi filloi me ndarjen e detyrave ndërmjet ekspertëve të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm, i cili, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), nisi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm dhe të dokumenteve mbështetëse që shoqëronin këtë raport. Në këtë fazë u identifikuan një sërë çështjesh dhe pyetjesh, të lidhura me përmbushjen e standardeve dhe kriterëve të parashikuara për akreditim, të cilat u adresuan në vijim gjatë vizitës në institucion. Për këtë proces akreditimi, ASCAL përzgjodhi dy ekspertë të jashtëm, **Prof. Dr. Iset Morina**, dhe **Dr. Dorina Gjipali**, të cilët, të mbështetur teknikisht nga Z. Muhamed Prezja staf teknik pranë ASCAL, realizuan vizitën institucionale në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës më datat 27 dhe 28 mars 2025.

Gjatë vizitës dyditore, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zhvilloi takime të strukturuar me përfaqësues të drejtuesve të Fakultetit të Drejtësisë, përfshirë Dekanin, Zëvendës Dekanin përgjegjës për programin, si dhe me drejtues të njësive bazë (Departamentit të Drejtës Civile, të Drejtës Penale dhe të Drejtës Publike), Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik, studentët, punonjës të sekretarisë mësimore etj.

Gjithashtu, gjatë vizitës u vëzhguan ambientet dhe biblioteka e fakultetit, për të vlerësuar infrastrukturën në funksion të zhvillimit të programit të studimit.

Përgjatë gjithë procesit të vlerësimit, u evidentua një angazhim serioz dhe një nivel i lartë bashkëpunimi nga ana e drejtuesve të Fakultetit të Drejtësisë. Dokumentacioni i kërkuar nga anëtarët e grupit të vlerësimit u vendos në dispozicion në kohë nga ana e institucionit.

Ky raport final paraqet vlerësimin e jashtëm të Programit të Integruar të Ciklit të Dytë të Studimeve "Master i Shkencave" në "Drejtësi", dhe do të shërbejë si bazë për vendimmarrjen për akreditimin e tij.

Universiteti i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 07.07.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 129/10 Prot, datë 07.07.2025. Universiteti i Tiranës më datë 17.07.2025, njofton nëpërmjet shkresës me Nr. 588/1 Prot, datë 17.07.2025, "*Dërgimi i komenteve në lidhje me draft raportin e vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit të programit të integruar të studimit të ciklit të*



dytë master i shkencave në "Drejtësi". Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, pasi u njoh me komentet e IAL mbi draft-Raportin, shprehet si më poshtë vijon:

- **Lidhur me komentin Standardi I.2, Kriteri 2,** GVJ vlerëson përpjekjet për hartimin e rregulloreve dhe sugjeron përmbylljen dhe miratimin e tyre në një afat sa më të shpejtë. Megjithatë, dokumentacioni nuk përmban rregulloret e miratuara. **Rekomandimi qëndron dhe raporti nuk ndryshohet.**
- **Lidhur me komentin Standardi I.2, Kriteri 4,** duke vlerësuar angazhimin GVJ sugjeron ndërtimin e një sistemi funksional për ndjekjen e karrierës të të diplomuarve dhe përgatitjen e raporteve periodike analitike që matin ndikimin e bashkëpunimeve dhe pjesëmarrjen në projekte në cilësinë e programit të studimit. **Rekomandimi qëndron dhe raporti nuk ndryshon.**
- **Lidhur me komentin Standardi II.4, Kriteri 2,** GVJ e konsideron të vlefshme mënyrën tradicionale të trajtimit të trashëgimisë brenda lëndës "E drejtë civile". **Komenti i GVB merret parasysh dhe RVJ ndryshon.** Shtohet në standardin II.4 kriteri 2: *"GVJ konstaton se sqarimi mbi përfshirjen e temave të trashëgimisë në lëndën "E drejtë civile" është në përputhje me qasjen akademike të përdorur në shumë institucione të arsimit të lartë në vend. Megjithatë GVJ e konsideron të rëndësishme që në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulës, fakulteti të eksplorojë mundësinë për të rritur peshën e trajtimit të lëndës "E drejtë e Trashëgimisë" në përputhje me nevojat dhe zhvillimet ligjore" si p.sh përfshirja e qartë në syllabuse apo krijimi i një moduli specifik mund të jenë masa të dobishme për të rritur peshën e saj."*
- **Lidhur me komentin Standardi IV.1, Kriteri 1,** GVJ vlerëson sqarimin dhe përpjekjet e ndërmarra nga institucioni për përmirësimin e cilësisë së stafit akademik të angazhuar në programin e ciklit të dytë të studimeve. Megjithatë, rekomandimi konsiderohet pjesërisht i përmbushur. GVJ thekson rëndësinë e respektimit të standardit ligjor dhe akademik, si një parakusht për garantimin e cilësisë në arsimin e lartë. Duke iu referuar pikës 6 të nenit 59 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ku përcaktohet se: *"Stafi akademik i përfshirë në programin e ciklit të dytë duhet të ketë një gradë më të lartë se niveli i programit të studimit"*, rezulton se angazhimi i stafit me vetëm gradën "Master i Shkencave" (MSc) në mësimdhënien e një programi të po këtij niveli nuk përputhet me kërkesat ligjore në fuqi. Në momentin e vlerësimit, kjo përputhshmëri nuk ishte arritur në mënyrë të plotë. **Rekomandimi qëndron dhe raporti nuk ndryshon.**
- **Lidhur me komentin Standardi IV.3, Kriteri 7,** GVJ e vlerëson iniciativën dhe angazhimin për zgjatjen e orarit. Në vlerësimin vijues do të pritet dokumentacion mbështetës që dëshmon zbatimin e plotë të këtij orari. **Rekomandimi qëndron dhe raporti nuk ndryshon.**



Vlerësimi i Programit të Integruar të Studimeve të Ciklit të Dytë “Master i Shkencave” në “Drejtësi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti i Tiranës, si Institucioni më i vjetër publik i Arsimit të Lartë në Shqipëri, ka filluar aktivitetin e tij akademik dhe shkencor në vitin 1957 dhe është i strukturuar në 7 njësi kryesore akademike, duke ofruar programe studimi në të tre ciklet e arsimit të lartë. Në përbërje të këtyre njësive ndodhet edhe Fakulteti i Drejtësisë, i cili përbëhet nga tre njësi bazë: 1. Departamenti i së Drejtës Civile; 2. Departamenti i së Drejtës Penale; 3. Departamenti i së Drejtës Publike; Programi i Integruar i Ciklit të Dytë “Master i Shkencave” në Drejtësi, i ofruar nga Fakulteti i Drejtësisë, është hartuar dhe zbatuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë dhe me aktet e brendshme të UT-së, përfshirë Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme. Ky program synon të përgatisë juristë të kualifikuar që kontribuojnë në forcimin e shtetit të së drejtës dhe në zhvillimin demokratik të vendit. Përmbajtja dhe objektivat e programit janë të orientuara drejt konsolidimit të vlerave akademike dhe kulturore kombëtare, përmes ofrimit të njohurive të thelluara juridike dhe formimit profesional të studentëve, të cilët përgatiten për të ushtruar funksione të rëndësishme në administratën publike, sistemin gjyqësor, sektorin privat dhe atë akademik. Në këtë kuadër, programi synon jo vetëm përgatitjen teorike dhe praktike të studentëve, por edhe edukimin e tyre me vlera demokratike, etikë profesionale dhe përgjegjësi qytetare, duke qenë në harmoni të plotë me interesat dhe nevojat e shoqërisë shqiptare dhe shtetit shqiptar.



	<i>Evidenca nr.2 Statuti i UT-së;</i> <i>Evidenca nr.3 Rregullorja e UT-së;</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Drejtësi” i përket ciklit të dytë të studimeve dhe është i strukturuar si një program i integruar, i riorganizuar në përputhje me Urdhrin nr. 396, datë 22.07.2019. Ky program ofrohet nga Fakulteti i Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, nga tre njësitë bazë akademike: Departamenti i së Drejtës Civile, Penale dhe Publike. Programi është hartuar në harmoni të plotë me misionin e Universitetit të Tiranës, i cili konsiston në formimin akademik dhe profesional të studentëve, përgatitjen e specialistëve dhe profesionistëve të lartë, si dhe në zhvillimin e kërkimit shkencor në shërbim të shoqërisë. Ai ka një përmbajtje mësimore që reflekton prioritetet strategjike të institucionit, të përcaktuara qartë në dokumente themelore si Statuti i UT, Strategjia e Zhvillimit 2018–2023 dhe Strategjia institucionale për mësimdhënien 2022–2027. Këto dokumente udhëzojnë për një qasje bashkëkohore ndaj formimit juridik, duke nxitur një edukim cilësor, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm. Përputhshmëria e programit me fushën e veprimtarisë akademike të Universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Drejtësisë është e dukshme në mënyrën si është ndërtuar kurrikula, si dhe në planin mësimor dhe syllabuset përkatëse. Këto dokumente pasqyrojnë objektivat e qarta të programit për të përgatitur juristë të aftë të kontribuojnë në sistemin gjyqësor, administratë, sektorin privat dhe në fushën akademike. Struktura e programit nxit integrimin e njohurive teorike me kompetencat praktike, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe me zhvillimet më të fundit në fushën e drejtësisë. Në këtë mënyrë, programi “Master i Shkencave” në “Drejtësi” jo vetëm që respekton misionin e institucionit dhe drejtimit e tij strategjike, por gjithashtu përmbush në mënyrë të qëndrueshme nevojat aktuale dhe afatgjata të sistemit arsimor dhe shoqërisë shqiptare. <i>Evidenca nr.14 Urdhëri i MASR mbi riorganizimin e programit të studimit Bachelor në Drejtësi në MSH në Drejtësi</i> <i>Evidenca nr.5 Strategjia e Zhvillimit të UT-së 2018-2023</i> <i>Evidenca nr. 5.1 Strategjia e Zhvillimit të UTsë 2023-2028</i> <i>Evidenca nr.7 "Strategjia Institucionale mbi Mësimdhënien e UT-së</i>

Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike të Institucionit.	Programi i studimit “Master i Shkencave në Drejtësi” hartohet dhe ofrohet në përputhje të plotë me Statutin, Rregulloren dhe Strategjitë e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës (2018–2023 dhe 2023–2028), duke reflektuar qëllimet institucionale për cilësi akademike, zhvillim të mendimit kritik, qytetari demokratike dhe përfshirje aktive në jetën publike. Programi mbështetet në strukturën akademike të Fakultetit të Drejtësisë dhe është në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të UT-së, duke garantuar koherencë mes objektivave institucionale dhe përmbajtjes mësimore. <i>Evidenca nr.5 Strategjia e Zhvillimit të UT-së 2018-2023</i> <i>Evidenca nr. 5.1 Strategjia e Zhvillimit të UT-së 2023-2028</i> <i>Evidenca nr.7 "Strategjia Institucionale mbi Mësimdhënien e UT-së</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	GVJ konstaton se programi i studimit “Master i Shkencave në Drejtësi” është hartuar dhe zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit dhe interesin kombëtar, si dhe në vijim të angazhimeve ndërkombëtare të vendit. Ai mbështetet në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020 dhe Strategjinë 2022–2030, të cilat theksojnë forcimin e sundimit të ligjit, të drejtave të njeriut dhe luftën kundër korrupsionit. Gjithashtu, programi përputhet me objektivat e Strategjisë Ndërsektorale për Drejtësinë 2021–2025 për përafrimin me standardet evropiane. Në të njëjtën kohë, ai reflekton prirjet globale për drejtësi, paqe dhe barazi, sipas dokumenteve ndërkombëtare të OKB-së, duke përgatitur juristë të aftë për sfidat kombëtare dhe ndërkombëtare. <i>Evidenca nr.8 "Strategjia Ndërsektorale për Drejtësinë 2021-2025</i> <i>Evidenca nr.11 "Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030</i>
Konkluzione	<i>Programi i Integruar i Ciklit të Dytë në "Drejtësi" ofrohet në përputhje të plotë me parimet bazë të institucionit, të sanksionuara në Statutin, Rregulloren e përgjithshme dhe Strategjitë institucionale afatmesme dhe afatgjata.</i> <i>Strategjia e zhvillimit e Universitetit të Tiranës përcakton qartë prioritetet institucionale dhe ato të programeve të studimit, duke synuar përgatitjen e profesionistëve me integritet, etikë dhe kompetenca të avancuara, në shërbim të tregut të punës</i>

	<i>dhe interesit publik, në përputhje me prioritetet kombëtare dhe prirjet globale në arsim dhe kërkim shkencor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Programi i studimit Master i Shkencave (PI) në "Drejtësi" ofrohet nga Fakulteti i Drejtësisë, njësi akademike kryesore me përvojë të konsoliduar dhe traditë të gjatë në fushën juridike. Fakulteti është themeluar në vitin 1954, fillimisht si "Instituti i Lartë Juridik", dhe më pas është integruar në Universitetin e Tiranës si një ndër njësitë themeluese të tij. Fakulteti ofron aktualisht programe në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve, dhe disponon kapacitetet akademike dhe burimet e nevojshme për realizimin cilësor të këtyre programeve. Për vitin 2024-2025, Fakulteti i Drejtësisë ka gjithsej 128 pedagogë, nga të cilët 91 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: - 16 kane titullin Prof. Dr.; - 37 kanë titullin Prof. As; - 19 kanë gradën Dr.; - 19 janë me Msc; dhe 37 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku: - 6 kanë titullin Prof. As; - 15 kanë gradën Dr.; - 16 janë me Msc; Stafi akademik i angazhuar në këtë program përbëhet nga pedagogë me grada dhe tituj shkencorë, të punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme, me ekspertizë të thelluar në fushën përkatëse dhe me përvojë shumëvjeçare në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Mbi 70% e programit mbulohet nga personel akademik efektiv i fushës juridike, çka siguron përputhje me




	kërkesat ligjore dhe ndikon në përmirësimin e cilësisë së formimit profesional të studentëve. Kjo tregon qartazi për kapacitetin dhe përgatitjen e njësive përgjegjëse për të ofruar një program të avancuar, të standardeve të larta akademike në fushën e drejtësisë. <i>Tabelat përmbledhëse aneks të RVB-së", tabela nr. 1, "Mbi të dhënat përmbledhëse të stafit akademik për programin e studimit, sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre për stafin akademik të angazhuar në PIND</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit "Master i Shkencave në Drejtësi" është krijuar dhe ofrohet në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Drejtësisë dhe departamenteve të përkatshme (Civile, Penale dhe Publike). Ky program zhvillohet në përputhje me udhëzimet kombëtare dhe evropiane të klasifikimit të programeve të studimit dhe është i nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Përfundimi i këtij programi të jep mundësinë e lëshimit të diplomës përkatëse, duke iu referuar udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MASR), siç përcaktohet në Udhëzimin Nr. 11, datë 02.04.2020, për përcaktimin e përmbajtjes dhe formës së suplementit të diplomës. Kjo siguron që programi i studimit të jetë në përputhje me standardet e kërkuara, duke u bazuar në fushën akademike dhe kërkimore të njësive përgjegjëse. FD-së i mungon një rregullore Fakulteti dhe rregulloret e departamenteve, megjithëse është detyrim i sanksionuar në nenin 12, pika 6, të Statutit të UT, sipas të cilit, veprimtaria e fakultetit mbështetet ndërmjet të tjerash edhe në rregulloren e fakultetit. <i>GVJ sugjeron, se FD / UT duhet të miratojë rregulloren e njësive kryesore dhe rregulloret e njësive bazë, për mbarvajtjen dhe mbështetjen e veprimtarisë, konform ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe statutit të UT.</i> <i>Evidenca nr.39.3 "Struktura e njësive kryesore, Fakulteti i Drejtësisë</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje	Programi "Master i Shkencave në Drejtësi" është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësive bazë përgjegjëse – Departamentet e së Drejtës Civile, Penale dhe Publike – të cilat operojnë brenda fushës së drejtësisë. Këto

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

10

me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	njësi akademike mbulojnë aspektet thelbësore të programit dhe zotërojnë kapacitetet e nevojshme për të garantuar cilësinë e ofrimit të tij. Duke qenë një program i specializuar në drejtësi dhe jo ndërdisiplinor, përputhja midis objektit të studimit dhe fushës së veprimtarisë kërkimore të njësisë bazë është e drejtpërdrejtë dhe e plotë. <i>Evidenca nr. 15 Rregullorja e programit të studimi të integruar të ciklit të dytë në Drejtësi</i> <i>Evidenca nr.39.3 Struktura e njësisë kryesore, Fakulteti i Drejtësisë</i>
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilin të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	N / A
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Nga takimet në FDUT u konstatua se Dega për Këshillimin e Karrierës dhe marrëdhënien me Alumni, luan një rol thelbësor në përgatitjen profesionale të studentëve dhe të diplomuarve për integrimin në tregun e punës. Kjo njësi funksionon si një urë lidhëse mes formimit akademik dhe kërkesave të tregut, duke ofruar mbështetje individuale dhe kolektive për studentët në orientimin e karrierës. Aktivitetet e zhvilluara përfshijnë këshillime, organizimin e trajnimeve të fokusuara në zhvillimin e kompetencave profesionale dhe të buta, si dhe ndërmjetësimin e kontakteve me punëdhënësit potencialë përmes aktiviteteve të përbashkëta. <i>Evidenca nr.39.3 Struktura e njësisë kryesore, Fakulteti i Drejtësisë</i>
Konkluzione	<i>FDUT ka përvojë të konsoliduar në fushën e drejtësisë, me kapacitete akademike dhe burime të mjaftueshme për ofrimin cilësor të programit të ciklit të dytë, në përputhje me standardet përkatëse.</i> <i>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është plotësisht në përputhje me profilin akademik dhe kërkimor të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse, sipas klasifikimeve dhe udhëzimeve kombëtare dhe evropiane. Programi i studimit mbështetet nga tre departamente që zotërojnë ekspertizën akademike dhe kërkimore në fushën</i>

	përkatëse, duke garantuar përputhshmëri të plotë me objektivat e tij formues. Institucioni ofron mbështetje aktive për studentët dhe të diplomuarit nëpërmjet Degës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, duke zhvilluar iniciativa për orientim profesional dhe bashkëpunim me punëdhënësit për trajnime dhe zhvillim të mëtejshëm. <u>GVJ sugjeron, se FD / UT duhet të miratojë rregulloren e njësisë kryesore dhe rregulloret e njësive bazë, për mbarëvajtjen dhe mbështetjen e veprimtarisë, konform ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe statutit të UT.</u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Në këtë kuadër, institucioni ka siguruar një strukturë të qartë dhe funksionale për hartimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit, e cila bazohet në ndarjen e përgjegjësisë dhe bashkëpunimin e ngushtë mes njësive akademike dhe administrative. Marrëdhëniet mes strukturave akademike dhe administrative janë të përcaktuara qartë në Statutin e Universitetit të Tiranës (UT), në Rregulloren e UT-së dhe në aktet e tjera të brendshme që rregullojnë veprimtarinë e përbashkët. Kjo ndihmon për të siguruar mbarëvajtjen e programit të studimit, duke përcaktuar qartë rolin e drejtuesve të njësive akademike dhe personelit përgjegjës për secilën fushë studimi. <i>Evidenca nr.2 Statuti i UT-së përfshirë detyrat dhe të drejtat e personelit akademik dhe administrativ.</i> <i>Evidenca nr.15 Rregullorja e programit të studimit të integruar të</i>

	<i>ciklit të dytë në Drejtësi</i> <i>Evidenca nr. 39.3 Struktura e njësive kryesore, Fakulteti i Drejtësisë</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës (FDUT) ka krijuar dhe konsoliduar një rrjet të gjerë bashkëpunimesh me institucione të arsimit të lartë (IAL) brenda dhe jashtë vendit, si dhe me aktorë të tregut të punës, me synimin për të përmirësuar cilësinë e arsimit dhe për të përgatitur studentët për sfidat e tregut profesional. Këto bashkëpunime shërbejnë si një mjet i rëndësishëm për realizimin e objektivave të programit të studimit, përmes zhvillimit të praktikave profesionale, programeve të mobilitetit dhe integritit të studentëve në tregun e punës. <i>Evidenca nr.27 Raportet vjetore të FDUT 2019–2023</i> <i>Evidenca nr.29.1 Marrëveshjet bilaterale të nënshkruara nga UT 2020–2024</i> <i>Evidenca nr.29.2 dhe 29.3 Lista e mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik në FDUT 2019–2023</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	FDUT ka ndërtuar një strukturë funksionale dhe të qëndrueshme bashkëpunimi me institucione publike dhe private, kombëtare dhe ndërkombëtare, me synim realizimin sa më cilësor të praktikave profesionale dhe fuqizimin e dimensionit kërkimor e ndërkombëtar të programit të studimit. Praktikave profesionale janë pjesë përbërëse e programit të studimit, të përcaktuara qartë në <i>Nenin 66</i> të Rregullores së Universitetit të Tiranës dhe realizohen në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara me institucione të profilin juridik dhe administrativ, të cilat shprehin dakordësinë për të pranuar studentët e FDUT për praktikë. FDUT bashkëpunon me institucione kërkimore, kompani dhe organizata të fushës përkatëse, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen nga punëdhënësit në vendin e praktikës dhe përfshirjen e tyre në zhvillimin e programeve. Fakulteti ka një strukturë të dedikuar për projektet dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, e cila fokusohet në identifikimin e mundësive për projekte ndërkombëtare, aplikime për grante kërkimore dhe partneritete strategjike në kuadër të programit Erasmus+ dhe iniciativave të tjera europiane. Programet e mobilitetit ndërkombëtar përfshijnë si studentët, ashtu edhe personelin akademik, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe përvetësimin e praktikave më të mira europiane. Fakulteti angazhohet gjithashtu në projekte

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

13



	kërkimore dhe zhvillimore, në bashkëpunim me universitete partnere, me fokus në: mobilitet, organizim të konferencave shkencore të përbashkëta, botime akademike, si dhe përmirësim të infrastrukturës arsimore dhe kërkimore. <i>Evidenca nr.2 Rregullorja e UT-së (neni 66 për praktikat)</i> <i>Evidenca nr.29.1 Marrëveshje bilaterale (2020–2024)</i> <i>Evidenca nr.29.6 Aktivitete të studentëve (2019–2024)</i> <i>Evidenca nr.32 Dokumentacion mbi praktikat mësimore (2024–2025)</i> <i>Evidenca nr.29 Tabela mbi projektet e FDUT (2019–2024)</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	GVJ vlerëson se FDUT ka ndërtuar një rrjet të gjerë bashkëpunimesh me institucione vendase dhe të huaja, i cili ka kontribuar pozitivisht në zhvillimin e programit të studimit, veçanërisht përmes praktikave profesionale dhe përfshirjes në projekte akademike e kërkimore. <i>Rekomandohet që FDUT të institucionalizojë më tej hartimin periodik të raporteve analitike që matin ndikimin e bashkëpunimeve në cilësinë e programit të studimit, të rrisë pjesëmarrjen në projekte ndërkombëtare dhe mobilitetin e studentëve e stafit, si dhe të krijojë një sistem të mirëfilltë për ndjekjen e karrierës së të diplomuarve.</i> <i>Evidenca nr.29.1 Marrëveshje bilaterale (2020–2024)</i> <i>Evidenca nr.29.6 Aktivitete të studentëve (2019–2024)</i> <i>Evidenca nr.32 Dokumentacion mbi praktikat mësimore (2024–2025)</i> <i>Evidenca nr.29 Tabela mbi projektet e FDUT (2019–2024)</i>
Konkluzione	GVJ vlerëson se FDUT ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në ndërtimin dhe forcimin e marrëdhënieve bashkëpunuese me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, universitete, institucione kërkimore dhe aktorë të tregut të punës. Marrëveshjet e nënshkruara dhe aktivitetet e realizuara kanë mbështetur zhvillimin e programit të studimit dhe kanë krijuar mundësi konkrete për studentët dhe stafin në fushat e praktikave profesionale, mobilitetit dhe kërkimit shkencor. <i>GVJ rekomandon një përforsim të mëtejshëm të monitorimit, vlerësimit dhe analizës së përfitimeve që burojnë nga këto</i>

	<i>bashkëpunime nëpërmjet hartimit të raporteve analitike të rregullta sidomos në sektorin e punësimit dhe ndjekjen sistematike të karrierës së të diplomuarve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Parimisht mund të konstatohet se programi i studimit është i qartë, i parashikueshëm dhe se merr në konsideratë kërkesat sipas kuadrit normativ vendas dhe sipas ECTS. Programi i Integruar i Studimeve të Ciklit të Dytë në “Drejtësi” është strukturuar dhe shtrihet në një periudhë kohore prej pesë vitesh akademike, duke përfshirë gjithsej 300 kredite ECTS. Studimet organizohen në dhjetë semestra. Programi përmban lëndë të klasifikuara sipas kategorive të parashikuara në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi (kategoritë A-E), në përputhje me standardet kombëtare të arsimit të lartë. <i>Evidenca nr 16. Plani Mësimor i Programit të Integruar të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Drejtësi;</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose	Një program i tillë studimi garanton përgatitje solide të juristëve të ardhshëm. Duke promovuar konceptin didaktik të studimit interaktiv dhe zgjidhjes së rasteve nëpërmjet shembujve hipotetikë dhe real do të mund të avancohej mëtej mësimnxënia dhe kompetenca profesionale dhe shkencore e studentëve. Programi i Integruar i Studimeve të Ciklit të Dytë në “Drejtësi” fokusohet në formimin akademik në fushën e së drejtës.

punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi përfshin lëndë bazë e karakterizuese, lëndë me karakter teoriko-praktik si dhe lëndë formuese ndërdisiplinore që kontribuojnë në formimin e gjerë të studentëve në fushën juridike. <i>Tabela nr. 9;</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Në përgjithësi mund të konstatohet se kurrikula e aprovuar dhe praktikuar siguron balancën ekuivalente të ngarkesës akademike dhe detyrimeve përmbyllëse. Pjesë e kurrikulës së këtij programi studimi është dhe praktika mësimore/intership, e cila zhvillohet në vitin e pestë akademik (semestri i dhjetë), me 12 ECTS. Kjo lëndë mbështetet nga stafi akademik mbikqyrës i praktikës mësimore. <i>Evidenca nr 16. Plani Mësimor i Programit të Integruar të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Drejtësi;</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit.	N / A
Kriteri 5. Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me	N / A



120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	UT është një institucion publik i Arsimit të Lartë dhe nuk gëzon status të veçantë në kuptim të kuadrit ligjor në fuqi. Forma e organizimit të studimeve dhe pranimi i studentëve kryhet në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Studimet e integruara Master i Shkencave në “Drejtësi” është program unik. Ky sistem me studim të tillë të integruar tejkalon standardin përmbajtësor të ofruar në programe të tjera të ngjashme. Programi i Integruar i studimeve të Ciklit të Dytë në “Drejtësi” paraqet një shkallë përafrimi rreth 70% me programet e ngjashme të ofruara nga universitete të tjera publike dhe private në vend. Kjo përputhshmëri, së bashku me strukturimin sipas sistemit të krediteve ECTS, lehtëson transferimin e studimeve brenda dhe jashtë vendit. <i>Evidenca nr 16. Plani Mësimor i Programit të Integruar të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Drejtësi;</i>
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra	Në zbatim të nenit 86, të Ligjit nr.80/2015, Këshilli i Ministrave dhe Ministria përgjegjëse për arsimin kanë hartuar aktet nënligjore përkatëse dhe në bashkëpunim me Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH, ka filluar së pari procesin e kodifikimit të programeve. UT ka bërë propozimet përkatëse në



publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	lidhje me kodifikimin e programeve të studimit ku për programin në fjalë ka propozuar kodin 75MI0421S . <i>Evidenca nr 17. Shkresë mbi Kodifikimin e Programit të Studimit;</i>			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i studimeve të integruara nuk paraqet në esencën problem në organizimin e përbashkët të studimeve apo edhe cikleve të përbashkëta të studimit. Programi i Integruar i studimeve të Ciklit të Dytë në "Drejtësi" nuk ofrohet në kuadrin e ndonjë bashkëpunimi të tillë pra ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.			
Konkluzione	<i>Programi i integruar i studimeve "Master në Drejtësi" organizohet duke respektuar kornizën normative kombëtare përkatëse.</i> <i>Lëndët janë të kategorizuara sipas kategorive të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi (kategorizimi A-E). Institucioni është në pritje të miratimit të kodifikimit të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Programi realizohet nga ana e tri departamenteve klasike. Në esencë, kjo formë e ofrimit të programit nga ana e këtyre departamenteve është edhe tradicionale edhe funksionale. Universiteti i Tiranës është institucion i akredituar në nivel institucional me 6 vite akademike duke përmbushur kërkesat ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Njësia përgjegjëse për ofrimin e Programit të Integruar të Ciklit të Dytë në "Drejtësi" është Fakulteti i Drejtësisë, i cili përbëhet nga tre njësi bazë:

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

18

1. Departamenti i së Drejtës Publike;
2. Departamenti i së Drejtës Civile;
3. Departamenti i së Drejtës Penale;

FD si njësia përgjegjëse për programin e studimit, për vitin akademik 2024-2025 ka në përbërjen e tij gjithsej 128 staf akademik, nga ku 91 janë staf akademik efektiv (PAE) dhe 37 staf akademik me kontratë (PAK) me kualifikimin e mëposhtëm:

Njësia bazë	PAE	Tituj/Grada	PAK	Tituj/Grada
Departamenti i së Drejtës Publike;	30	4 – Prof. Dr. 11– Prof. Asoc. 8 – Dr. 7- Msc	17	0 – Prof. Dr. 4– Prof. Asoc. 6– Dr. 7– Dr. në Proc. 0- Msc
Departamenti i së Drejtës Civile;	32	6– Prof. Dr. 13– Prof. Asoc. 6– Dr. 7 – Dr. në Proc. 0 - Msc	14	0– Prof. Dr. 2– Prof. Asoc. 7– Dr. 5 – Dr. në Proc. 0 - Msc
Departamenti i së Drejtës Penale;	29	6 – Prof. Dr. 13– Prof. Asoc. 5 – Dr. 5– Dr. në Proc 0 - Msc	6	0– Prof. Dr. 0– Prof. Asoc. 2 – Dr. 4 – Dr. në Proc. 0 - Msc
Total		91		37

Cdo njësi bazë është e përbërë nga të paktën 7 anëtarë të

	personelit akademik me kohë të plotë, ku shumica prej tyre janë me tituj dhe gradë shkencore Prof, Prof.As dhe Dr. Sa më sipër, fakulteti përmbush detyrimet ligjore e nënligjore në fuqi në lidhje me numrin e personelit akademik, kualifikimet, ngarkesën, numrin e lëndëve të zhvilluara dhe përputhshmërinë e lëndës me përgjegjësin e saj. <i>Tabelat përmbledhëse për aneks RVB-në", tabelat nr. 1, 2, 6.1, 7 dhe 8</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Caktimi i koordinatorit për programin në tërësi siguron mbarëvajtje dhe rregullsi organizative dhe përmbajtësore. Njësitë përgjegjëse për programin e studimit përmbushin kërkesat ligjore për realizimin e praktikave mësimore. Studentët zhvillojnë praktikën nën mbikëqyrjen e pedagogëve përkatës, ndërsa përfshirja e stafit në Klinikën e Ligjit u jep studentëve mundësi të përfitojnë përvojë praktike në profesionet ligjore. Në Fakultetin e Drejtësisë janë të punësuar 3 personel ndihmës-akademik (laborantë), të cilët mbështesin stafin akademik dhe studentët gjatë realizimit të proceseve akademike. <i>Tabelat përmbledhëse për aneks RVB-në", tabelat nr. I;</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Referuar RVB-së, dhe vërtetuar gjatë vizitës në institucion koordinatori i programit të Integruar të Studimeve të Ciklit të Dytë në "Drejtësi" është Zv. Dekani i Fakultetit të Drejtësisë, i cili mbikëqyr dhe ndjek zbatimin e programit në përputhje me objektivat mësimorë dhe standardet akademike të përcaktuara.
Konkluzione	<i>Departamentet janë të organizuar mirë dhe me koordinatorët e emëruar do mund të funksionojë programi në mënyrë solide. Fakulteti përbëhet nga staf akademik me më kohë të plotë (PAE) dhe me kohë të pjesshme (PAK), të cilët kanë kualifikimet e duhura akademike dhe profesionale, duke përmbushur standartet e përcaktuara ligjore.</i>
Shkalla e përmbushjes së	Nuk Përmbushet Përmbushet Përmbushet

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

20

standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Njësia kryesore, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Njësia kryesore, përgjegjëse për programin e studimit disponon Rregulloren e Universitetit, Rregulloren e Programit të studimit. <i>Evidenca nr 5. Rregullorja e Programit të Studimi të Integruar të Ciklit të Dytë në Drejtësi;</i> <i>Evidenca nr 16. Plan i Mësimor i Programit të Integruar të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Drejtësi;</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Plani mësimor është i qartë, i qasshëm dhe i parashikueshëm. Programi i Integruar i Studimeve të Ciklit të Dytë në “Drejtësi” bazohet në aktet e brendshme të institucionit dhe është i strukturuar sipas sistemit ECTS. Kurrikula përfshin lëndë semestrale dhe të ndara në dy semestra, me ndarje të qartë të orëve në auditor dhe jashtë tij. Lëndët kryesore si E Drejta Kushtetuese, E Drejta Civile, Penale, e Detyrimeve dhe Administrative, Procedura Civile, Prodedura Penale por edhe lëndë të tjera zhvillohen në dy semestra, duke siguruar thellim të njohurive teorike dhe praktike. <i>Evidenca nr 16. Plan i Mësimor i Programit të Integruar të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Drejtësi</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të	Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. <i>Kreu III, neni 9</i> në Rregulloren e Programit të Studimit, jep kriteret dhe procedurat e pranimit të studentëve. Pranimi në Programin e Studimit të Integruar të Ciklit të Dytë në Drejtësi, bëhet sipas rregullave dhe kuotave të përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse që nxjerr Këshilli i Ministrave,

studimeve.	MAS, UT apo Fakulteti i Drejtësisë për vitin akademik përkatës. Në këtë Program Studimi mund të pranohen vetëm ata persona që kanë përfunduar arsimin e mesëm dhe kur kanë përfunduar jo më pak se 12 vjet shkollë në ciklet parauniversitare. Sipas nenit 12 të rregullores, një formë e pranimi të studentëve është edhe transferimi. UT lejon transferimet e studentëve në hyrje dhe në dalje brenda programeve të të njëjtit cikël studimi, ndërmjet IAL publike ose jopublike, vendase apo të huaja, sipas procedurave të parashikuara në rregulloren e UT. <i>Evidenca nr 5. Rregullorja e Programit të Studimi të Integruar të Ciklit të Dytë në Drejtësi;</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Syllabuset e plotësuar dhe të dërguara janë të plota, të qarta dhe të parashikueshme për studentët. Kurrikula e programit përmban informacion të detajuar mbi lëndët, orët akademike, ndarjen e tyre në leksione dhe seminare, si dhe orët e punës individuale të studentëve, duke përfshirë edhe numrin e krediteve ECTS dhe semestrin/vitin akademik të zhvillimit. Ky informacion i ofrohet studentëve që në regjistrim dhe mbahet i aksesueshëm nga struktura akademike dhe administrative gjatë gjithë periudhës së studimit. <i>Rekomandohet që korniza normative të mos konsiderohet "literaturë". Rekomandohet, që në syllabus të spikaten ligjet veçanërisht dhe jo së bashku me literaturën bazë dhe të rekomanduar.</i> <i>Evidenca nr 16. Plan i Mësimor i Programit të Integruar të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Drejtësi</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Referuar RVB-së dhe vizitës në institucion programi i studimit është objekt i një procesi të vazhdueshëm përmirësimi dhe përditësimi, i cili garanton përputhshmërinë me zhvillimet më të fundit në fushën e Shkencave Juridike dhe nevojat e tregut të punës. Në fillim të çdo viti akademik, realizohet një rishikim dhe miratim i ndryshimeve eventuale të përmbajtjes së programit. Si program i ri i integruar mund të përmirësohet ende në mënyrë evolutive. <i>Evidenca nr 16. Plan i Mësimor i Programit të Integruar të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Drejtësi</i>
Konkluzione	<i>Me rekomandimin e parashtruar, mund të konstatohet se programi integruar është i qartë, i detajuar dhe i</i>

	<i>parashikueshëm.</i> <i>Kurrikula është e strukturuar dhe ofron të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët (sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi), duke detajuar informacionin në formën e duhur akademik. .</i> <i>Programi i studimit parashikon qartësisht kriteret dhe procedurat për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. Pranimi bëhet sipas kuotave dhe rregullave të përcaktuara nga autoritetet përkatëse, ndërsa transferimi lejohet brenda të njëjtit cikël studimi sipas procedurave të miratuara nga UT.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi Master i Shkencave në Drejtësi është projektuar dhe zbatuar për të ofruar një edukim të thelluar dhe gjithëpërfshirës në fushën e drejtësisë. Emërtimi i programit është i qartë, përputhet me objektivat akademike dhe profesionale të tij, dhe reflekton qartësisht fushën e studimit që mbulon. Ky emërtim i ofron studentëve një qasje të integruar, duke u garantuar njohuri dhe aftësi të avancuara për të përmbushur kërkesat e tregut të punës ose për të ndjekur studime të mëtejshme. Programi siguron përgatitje solide për avancimin akademik dhe për nevojat e tregut të punës. Emërtimi dhe përmbajtja e kurrikulës së programit të Integruar të Studimeve të Ciklit të Dytë në "Drejtësi" është në përputhje të plotë me njohuritë që ofrohen përmes lëndëve që janë pjesë e këtij programi. Objektivat e përgjithshme të programit të studimit, sipas pikës 1, neni 4 i Rregullores së Programit të Studimit, paraqiten si më poshtë: - Ky program ofrohet në përputhje me misionin dhe

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Nr. 219, Tiranë

Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

23

	qëllimet e Universitetit të Tiranës, si dhe të Fakultetit të Drejtësisë. Gjithashtu ky program përputhet me misionin e përgjithshëm të arsimit të lartë në Shqipëri sipas specifikimeve në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, sisi dhe me strategjinë për zhvillim të IAL; - Programi, është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nuk bie ndesh me interesat dhe vlerat kulturore kombëtare; - Ky program studimi ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij; - Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek Programin e Studimit të Integruar të Ciklit të Dytë në Drejtësi është 60 kredite. Kohëzgjatja normale e këtij programi është 5 vjet. Studenti në fund të këtij programi grumbullon 300 kredite; - Ky Program studimi i Ciklit të Dytë synon pajisjen me njohuritë të thelluara mbi të drejtën në Shqipëri; <i>Evidenca nr 5. Rregullorja e Programit të Studimi të Integruar të Ciklit të Dytë në Drejtësi;</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënës dhe kërkimit shkencor.	Programi i studimit Master i Shkencave në: “Drejtësi” zhvillohet në pesë vite akademike dhe ka një ngarkesë totale kreditesh europiane prej 300 ECTS. Një kredit ECTS zhvillohet në 25 orë mësimi dhe në total programi i studimit zhvillohet në $300 * 25 = 7500$ orë mësimore. Në rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave Drejtësi, <i>pika 3 neni 4</i>, përcaktohet se programi i studimit synon: - Pajisjen me njohuritë bazë mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme në drejtësi; - Afrimin e mundësive për thellim të mëtejshëm të njohurive; - Përgatitjen e specialistëve sa më të aftë që i nevojiten tregut të punës në përputhje me nevojat e këtij tregu; - Të ofrojë mundësi për mobilitetin e studentëve si brenda dhe jashtë vendit; - Të realizojnë misionin që parashikon ligji për arsimin e lartë

	si dhe misionin e UT; Në përgjithësi mund të konstatohet se ky kriter relevant është i përmbushur. Semestri i parë dhe i dytë janë paksa të ngarkuar ekskluzivisht me lëndë të fushës të së drejtës publike. Por, meqë kjo përkon edhe me aspektet tradicionale të formimit të juristit, mund të pranohet kjo qasje si e tillë. GVJ konstaton se sqarimi mbi përfshirjen e temave të trashëgimisë në lëndën "E drejtë civile" është në përputhje me qasjen akademike të përdorur në shumë institucione të arsimit të lartë në vend. Megjithatë GVJ e konsideron të rëndësishme që në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulës, fakulteti të eksplorojë mundësinë për të rritur peshën e trajtimit të lëndës "E drejtë e Trashëgimisë" në përputhje me nevojat dhe zhvillimet ligjore" si p.sh përfshirja e qartë në syllabuse apo krijimi i një moduli specifik mund të jenë masa të dobishme për të rritur peshën e saj. <i>Evidenca nr 5. Rregullorja e Programit të Studimi të Integruar të Ciklit të Dytë në Drejtësi;</i> <i>Evidenca nr 16. Plani Mësimor i Programit të Integruar të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Drejtësi</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Bazuar në planin mësimor të programit të studimeve "Master i Shkencave" në "Drejtësi", rezulton se ky program ka gjithsej 39 lëndë, nga të cilat 5 janë të ndara në module. Shpërndarja e krediteve ECTS varion nga 3 në 12 ECTS, konkretisht: 3 ECTS – 1 lëndë 4 ECTS – 8 lëndë 6 ECTS – 9 lëndë 8 ECTS – 6 lëndë 9 ECTS – 1 lëndë 10 ECTS – 7 lëndë 12 ECTS – 7 lëndë Disiplinat janë të organizuara në kategori sipas klasifikimit A, B, C, D dhe E, në përputhje me përqindjet e përcaktuara në VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar. Emërtimet e lëndëve dhe syllabuset e tyre janë të ngjashme me ato të universiteteve të tjera, duke ndjekur struktura dhe përmbajtje të krahasueshme. Disiplinat përfshijnë formën e orëve mësimore

	Leksion/Seminar, ku kombinohen komponentët teorikë dhe praktikë. Raporti i lëndëve teorike me ato praktike është i përshtatshëm për këtë program studimi dhe në përputhje me objektivat e tij. Nga 7500 orë në total, orët në auditor janë 3064 orë, që përfaqësojnë 40.1% të ngarkesës së përgjithshme të programit, ndërsa 4436 orë ose 59.9% i takojnë studimit individual jashtë auditorit. Struktura e këtij programi studimi është projektuar në mënyrë të tillë që të lehtësojë mobilitetin e studentëve, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. Në kontekstin kombëtar, mobiliteti është i realizueshëm në mënyrë të natyrshme falë përputhshmërisë së këtij programi si detyim ligjor me programe të ngjashme të ofruara nga universitetet e tjera në vend.																								
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Programi mundëson arritjen e objektivave të paracaktuara si dhe për transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim. Struktura e programit lehtëson mobilitetin e studentëve brenda dhe jashtë vendit, duke qenë i përshtatshëm dhe i afërt me programet e universiteteve të tjera kombëtare. Kjo organizim i mirë i programit mundëson transferimin e lehtë të krediteve dhe vazhdimësinë e studimeve edhe në institucione jashtë Shqipërisë. Sipas Kurrikulës së Programit Msc “Drejtësi”, lëndët ndahen në: <table><tr><th>Kategoria</th><th>Tipi i komponentit mësimor</th><th>Sipas VKM 41/2018, e ndryshuar</th><th>Sipas programit të studimit</th></tr><tr><td>A</td><td>Lëndë bazë</td><td>15 % - 20 % (kredite)</td><td>19.3 % (58 kredite)</td></tr><tr><td>B</td><td>Lëndë karakterizuese</td><td>45% -55% (kredite)</td><td>54.6 % (164 kredite)</td></tr><tr><td>C</td><td>Lëndë ndërdisiplinore/ integruese</td><td>12% -15% (kredite)</td><td>14 % (42 kredite)</td></tr><tr><td>D</td><td>Lëndë Plotësuese</td><td>6-8% (kredite)</td><td>8 % (24 kredite)</td></tr><tr><td>E</td><td>Detyrime përmbyllëse</td><td>3% -5% (kredite)</td><td>3 % (9 kredite)</td></tr></table>	Kategoria	Tipi i komponentit mësimor	Sipas VKM 41/2018, e ndryshuar	Sipas programit të studimit	A	Lëndë bazë	15 % - 20 % (kredite)	19.3 % (58 kredite)	B	Lëndë karakterizuese	45% -55% (kredite)	54.6 % (164 kredite)	C	Lëndë ndërdisiplinore/ integruese	12% -15% (kredite)	14 % (42 kredite)	D	Lëndë Plotësuese	6-8% (kredite)	8 % (24 kredite)	E	Detyrime përmbyllëse	3% -5% (kredite)	3 % (9 kredite)
Kategoria	Tipi i komponentit mësimor	Sipas VKM 41/2018, e ndryshuar	Sipas programit të studimit																						
A	Lëndë bazë	15 % - 20 % (kredite)	19.3 % (58 kredite)																						
B	Lëndë karakterizuese	45% -55% (kredite)	54.6 % (164 kredite)																						
C	Lëndë ndërdisiplinore/ integruese	12% -15% (kredite)	14 % (42 kredite)																						
D	Lëndë Plotësuese	6-8% (kredite)	8 % (24 kredite)																						
E	Detyrime përmbyllëse	3% -5% (kredite)	3 % (9 kredite)																						



	Nga sa më sipër ndarja e veprimtarive formuese të programit të studimit është në përputhshmeri me VKM 41/2018, e ndryshuar. <i>Evidencë Tabelat 9-11</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Syllabuset janë, në përgjithësi, të detajuara, të plota dhe të qarta. Literatura përditësohet. Edhe këtu vlen i njëjti rekomandim, si më parë. Korniza normative nuk konsiderohet "literature". <u>Rekomandohet, që në syllabus të spikaten ligjet veçanërisht dhe jo së bashku me literaturën bazë dhe të rekomanduar.</u> Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi përditëson dhe përmirëson vazhdimisht programet e lëndëve, duke i përshtatur ato me qëllimet mësimore dhe zhvillimet bashkëkohore në fushën e së drejtës, sipas diskutimeve të dokumentuara në takime. <i>Evidencë Tabela nr.10 Plani mësimor PIND Drejtësi FDUT;</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimën e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Programi siguron përgatitje solide për arritjen e njohurive të domosdoshme dhe kompetencës profesionale dhe akademike. Ky program studimi, i nivelit 7 të KSHK, ofron studentëve njohuri të thelluara në fushën e së drejtës kombëtare dhe ndërkombëtare. Stafi akademik aplikon metodologji akademike të përshtatshme që siguron përvetësimin e njohurive akademike dhe shkencore nga studentët. <i>Evidenca nr 5. Rregullorja e Programit të Studimi të Integruar të Ciklit të Dytë në Drejtësi;</i> <i>Evidenca nr 16. Plani Mësimor i Programit të Integruar të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Drejtësi</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimitin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Realizimi i programit të paraparë është bazë e fortë për avancim të mëtejshëm akademik dhe profesional të studentëve dhe për përgatitje për treg të punës. Programi i Integruar i Ciklit të Dytë në "Drejtësi" siguron të diplomuarve mundësinë për të vijuar studimet në Ciklin e Tretë, si dhe përgatitjen e tyre për tregun e punës dhe profesionet ligjore si noteri, avokat dhe magjistrat. Kurrikula e programit ofron njohuri të thelluara në të drejtën publike, penale dhe civile, duke u përshtatur me kërkesat profesionale dhe akademike. <i>Evidenca nr 16. Plani Mësimor i Programit të Integruar të Ciklit të</i>

	<i>Dytë Master i Shkencave në Drejtësi</i>			
Konkluzione	<i>Programi i Integruar i Studimeve të Ciklit të Dytë në "Drejtësi" është i strukturuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke përfshirë 10 semestre akademike në 5 vite me gjithsej 300 ECTS, ku secili vit përmban 60 ECTS.</i> <i>Ky program ofron njohuri të thelluara në fushën e së drejtës dhe lejon studentët të ndërthurin dijet teorike me ato praktike, duke iu përshtatur objektivave arsimore përkatëse. Programi siguron përgatitje solide për arritjen e njohurive të domosdoshme dhe kompetencës profesionale dhe akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecures së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Në nivel fakulteti është i ngritur një strukturë e tillë organizative, e cila realizon këtë detyrë imanente. Procesi i zhvillimit dhe përmirësimit të Programit të Integruar të Ciklit të Dytë (PIND) është i vazhdueshëm dhe gjithëpërfshirës, duke u bazuar në konsultime të rregullta me aktorë të ndryshëm si institucione partnere, të diplomuar, përfaqësues të tregut të punës dhe studentë. Kjo siguron që programi të jetë gjithmonë në përputhje me nevojat aktuale të profesionit dhe kërkesat e tregut të punës. Programi rishikohet dhe përditësohet vazhdimisht, duke përfshirë përmirësimin e lëndëve, syllabuseve dhe literaturës, për t'i përshtatur me zhvillimet më të fundit në fushën e drejtësisë dhe legjislacionit. Në nivel institucional dhe fakulteti funksionojnë komisione të specializuara për sigurimin e cilësisë dhe monitorimin e zhvillimeve të programit, duke marrë në konsideratë edhe mendimet e tregut të punës, stafit akademik dhe studentëve. Ky mekanizëm mbikëqyrës garanton që programi të qëndrojë konkurrues, relevant dhe i përshtatshëm për sfidat praktike dhe teorike të profesionit, duke përgatitur studentët për një treg

	pune në ndryshim të vazhdueshëm dhe duke i aftësuar ata të kontribuojnë në zhvillimin e sistemit të drejtësisë dhe shoqërisë. <i>Evidenca 28 Raport Për Alumni-Dega e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni FDUT;</i> <i>Evidenca 29 Tabela mbi Projektet të FDUT 2019-2024;</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Gjatë vizitës në instiucion në bashkëbisedim me studentët është konstatuar një bashkërendim dhe bashkëpunim i ngushtë për realizimin me sukses dhe avancimin e programit. Fakulteti i Drejtësisë synon të rrisë përfshirjen aktive të studentëve në proceset vendimmarrëse universitare, përmes përfaqësimit të tyre në organe si Senati Akademik, Këshilli i Etikës dhe Komiteti Shkencor e Bursues, duke u dhënë mundësinë të ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e politikave akademike dhe përmirësimin e programeve të studimit. Studentët e dalluar përfshihen gjithashtu në aktivitete kërkimore dhe akademike si projekte, botime, konferenca dhe ëorkshop-e, duke zhvilluar aftësitë e tyre shkencore dhe kontribuar në përparimin e dijes në fushën e drejtësisë. Zyra e alumni-t luan një rol kyç në ruajtjen e lidhjes me të diplomuarit dhe në ndërlidhjen e tyre me mundësi profesionale e akademike, duke ndihmuar në përmirësimin e vazhdueshëm të programit. Ky bashkëpunim i ngushtë mes studentëve, fakultetit dhe aktorëve të tjerë siguron cilësi të lartë dhe përputhshmëri të programit me kërkesat e tregut dhe zhvillimet shkencore. <i>Evidenca 29.6 Studentë të Angazhuar në Takime dhe Aktivitete të Realizuara 2019-2024;</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Përcaktimi i fakultetit për këtë lloj programi duket të ketë qenë rezultat i konsultimeve paraparake me shumë aktorë. Programi është i ri dhe shumë premtues. Njësia përgjegjëse për programin PIND angazhohet në mënyrë të vazhdueshme për përmirësimin dhe përditësimin e programit, në përputhje me zhvillimet më të fundit në fushën e drejtësisë. Ky proces mbështetet në bashkëpunime të ngushta me aktorë të ndryshëm si rrjete profesionistësh, shoqata dhe organizata të fushës, me qëllim sigurimin e një lidhjeje të fortë ndërmjet programit dhe kërkesave të tregut të punës. Përmes këtyre partneriteteve, programi përshtatet me sfidat dhe nevojat aktuale, duke garantuar që studentët të fitojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të qenë konkurrues. Rekomandimet e partnerëve dhe aktorëve të jashtëm reflektohen në përmbajtjen e

	kurrikulës, strukturën e lëndëve dhe metodat e mësimdhënies, duke siguruar që programi të mbetet bashkëkohor dhe i përshtatshëm. <i>Evidenca 29.1 Marrëveshje Bilaterale të Nënshkruara nga UT 2020-2024;</i> <i>Evidenca 29.9 Takime me Partner dhe Bashkëpunëtorë FDUT 2019-2024;</i>			
Konkluzione	<i>Si konstatim i përgjithshëm mund të theksohet se fakulteti ka një bashkëpunim të ngushtë me shumë aktorë relevant dhe me studentët për realizimin e programit me synimin e arritjes së objektivave të përcaktuara dhe të parapara.</i> <i>GVJ konstaton se Programi PIND dëshmon një angazhim të qëndrueshëm për përmirësim dhe përditësim në përputhje me kërkesat dinamike të tregut të punës dhe zhvillimet shkencore në fushën e drejtësisë. Përdorimi i mekanizmave institucionale të mbikëqyrjes dhe përfshirja e vazhdueshme e aktorëve të jashtëm reflektojnë një qasje proaktive dhe të mirëstrukturuar për garantimin e cilësisë së programit.</i> <i>Fakulteti ka krijuar hapësira konkrete për pjesëmarrjen e studentëve në organet vendimmarrëse dhe veprimtari kërkimore, duke nxitur një kulturë të bashkëqeverisjes dhe përgatitjes profesionale.</i> <i>Kjo përfshirje jo vetëm fuqizon zërin e studentëve në formësimin e programeve, por edhe nxit zhvillimin e tyre personal dhe akademik. Zhvillimi i marrëveshjeve bilaterale dhe bashkëpunimi i ngushtë me organizata dhe institucione të lidhura me fushën e drejtësisë përbën një vlerë të shtuar për programin. Ky bashkëpunim lejon reflektimin e nevojave reale të tregut në strukturën dhe përmbajtjen e kurrikulës, duke e bërë programin më praktik, të orientuar drejt punësimit dhe të qëndrueshëm në kohë.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

30




Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi siguron një ekuilibër në parimin “mjete i përshtatshëm për qëllim”. Në këtë sens mund të konstatohet se objektivat fisnike të institucionit janë të realizueshme duke pasur në konsideratë përcaktimin e qartë të prioritetëve në synimeve në studime dhe hulumtime shkencore. Kurrikula e këtij programi studimi është hartuar në përputhje me objektivat strategjikë të institucionit, duke reflektuar prioritetet për ndërkombëtarizimin dhe zhvillimin e kërkimit shkencor. Në rregulloren e programit të studimit Msc në Drejtësi përcaktohen misioni dhe objektivat formuese të programit të studimit. Programi synon formimin e studiuesve dhe profesionistëve të rinj në fushën e drejtësisë. Për arritjen e këtij objekti ofrohet një bazë studimore teorike, kërkimore dhe profesionale. <i>(Rregullore e programit të studimit, neni 4).</i> <i>Evidenca 15. Rregullorja e Programit të Studimi të Integruar të Ciklit të Dytë në Drejtësi;</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Institucioni siguron parimin e autonomisë dhe atë të lirisë akademike dhe njëkohësisht parasheh intstrumente efikase për realizimin e detyrave sipas programit të paraparë. Referuar RVB-së, Fakulteti i Drejtësisë zhvillon aktivitete përtej procesit mësimor, si psh. Takime/leksione të hapura me profesorë të huaj, aktivitete në kuadër të projekteve kërkimore, konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. <i>Evidenca 22. Leksione të Hapura;</i> <i>Evidenca 29.10 Procesverbalet e Mbledhjeve të Departamentit;</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Ky program i ri mund të jetë më atraktiv për studentët në nxënien e njohurive profesionale dhe shkencore. Studentët njoftohen me anë të platformave online në lidhje me aktivitete apo mundësitë e reja për ta. Studentët nxiten të aksesojnë bibliotekat online dhe të realizojnë kërkime shkencore dhe projekte kursi. Studentët nxiten të marrin pjesë në trajtime dhe leksione të hapura apo konkurse të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare që zhvillohen. <i>Evidenca 29.6 Studentë të Angazhuar në Takime dhe Aktivitete të Realizuara 2019-2024;</i>

	<i>Evidenca 43. Thirrje për Studentët për Pjesëmarrje në Grupet Kërkimore;</i>			
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Institucioni është njësi autonome financiare sipas rregullave të së drejtës publike. Fakulteti ka një kuadër të avancuar normativ për financimin efikas dhe objektiv të njësive bazë në punën e tyre shkencore dhe profesionale. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia kryesore mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme. Mbështetja financiare realizohet me anë të autonomisë financiare (<i>Statuti, neni 7</i>). <i>Evidenca 2. Statuti i UT-së;</i> <i>Evidenca 39.1 Realizimet dhe Propozimet për Buxhetin e Viteve 2019-2023_compressed;</i>			
Konkluzione	<i>Programi është unik, i qartë, i parashikueshëm edhe duke iu referuar synimit për orientimin e studimit dhe kërkimit shkencor.</i> <i>Programi ka si objektiv të pajisë studentët me njohuri bashkëkohore në fushën e drejtësisë, duke mundësuar njohuritë e nevojshme për tregun e punës dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Këto objektiva janë në përputhje me misionin dhe objektivat e UT.</i> <i>Programi i studimit është përshtatur dhe me objektivat bazë strategjike të institucionit, të cilat lidhen me ndërkombëtarizimin dhe kërkimin shkencor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-	Njësia bazë është ka një strukturë të avancuar organizative dhe në këtë edhe mund të mbështet punën hulumtuese, edhe nëpërmjet bashkëpunimit me organizma të tjerë shkencor. Jemi të informuar se departamentet përkatëse ofrojnë ndihmën dhe

shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	bashkëpunimin në këtë aspekt. <i>Evidenca 29. Tabela mbi Projektet të FDUT 2019-2024;</i> <i>Evidenca 29.1 Marrëveshje Bilaterale të Nënshkruara nga UT 2020-2024;</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Departamentet përkatëse janë shumë aktive në inicimin dhe përkrahjen e nevojshme për personelin akademik në punën e tyre kërkimore shkencore. E njëjta gjë mund të vërehet edhe në raport me studentët. Fakulteti i Drejtësisë ka realizuar një sërë leksionesh të hapura me në fokus studentin disa si më poshtë: - Në Mars - Maj të 2023 Fakulteti ka mirëpritur studiuesin amerikan të Fullbright-it, Z. J.Sh, duke kontribuar në zhvillimin e përbashkët të një sërë leksionesh në lëndë të ndryshme; - Në Janar 2024 është zhvilluar leksioni i hapur me temë "Juridiksionet kushtetuese në revolucionin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, nga Prof T.G pedagoge në Universitetin e Sienës Itali; - Në prill 2024 është zhvilluar një takim me përfaqësues të Ambasadës Franceze mbi ecurinë dhe perspektivën e anëtarësimit në BE; <i>Evidenca 22. Leksione të Hapura;</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Fakulteti mund të krenohet, sidomos në këtë aspekt. Departamentet janë shumë aktive në organizimin e konferencave me karakter shkencor. Këtu mendohet jo vetëm në konferenca për personelin akademik, por edhe për studentët. Fakulteti i Drejtësisë organizon çdo vit Konferencën Shkencore të Fakultetit. Konferencat ju vijnë në ndihmë stafit akademik për të realizuar punime dhe kërkime shkencore të nevojshme për avancimin e tyre në karrierë dhe për të pasuruar dhe përditësuar literaturën e lëndëve. Studentët realizojnë kërkime të cilat do ti ndihmojnë në punimin e Mikrotezës dhe për të njohur tregun e punës. <i>Evidenca 22. Leksione të Hapura;</i>
Kriteri 4. Programi i	Programi i ri i fakultetit paraqet një bazë të fortë për



studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	formësimin e juristëve të ardhshëm edhe për tregun kombëtar edhe ndërkombëtar. Qëllimi i programit të studimit realizohet me anë të lëndëve dhe moduleve përbërëse, analizës së tregut të punës dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit që institucioni ka lidhur me institucione të tjera publike dhe private. Me anë të mobiliteteve jashtë vendit mundësohet pajisja e studentëve me njohuri të nevojshme si për tregun vendas ashtu edhe për tregun ndërkombëtar. <i>Evidenca 28.1 Studim Tregu 2022 për Studentët që Diplomohen në UT;</i> <i>Evidenca 7. Strategjia institucionale për mësimdhënien UT-së 2022-2027;</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Mund të konstatohet një kujdes të departamenteve përkatëse për respektimin e kuadrit përkatës normativ për formësimin e profesionit të juristit. Në këtë mendohet edhe marrjen me konsideratë të rekomandimeve të aktorëve të tjerë relevantë përkatës. Programi i studimit zhvillohet në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, dhe udhëzimet në fuqi.
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Përkundër faktit se studimet juridike paraqesin rend unik të avancimit arsimor në bazë të kuadrit përkatës normativ, programi merr në konsideratë edhe standardet ndërkombëtare të Unionit Evropian. Programi jo vetëm ndihmon në përgatitjen e studentëve për kualifikime profesionale, por i përgatit ata në nivel përfaqësimi kombëtar dhe/ose ndërkombëtar si "Avokatura e Shtetit", duke u licensuar si përfaqësues ligjor në Gjykatat Ndërkombëtare dhe në Arbitrazh Ndërkombëtar. <i>Evidenca 16. Plani Mësimor i Programit të Integruar të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Drejtësi;</i>
Konkluzione	<i>Programi i inkorporuar në institucion siguron bindshëm arritjen e njohurive të domosdoshme akademike dhe shkencore. Ky program garanton padyshim edhe ndërkombëtarizim të arsimimit juridik shqiptar.</i> <i>Fakulteti i drejtësisë organizon çdo vit Konferencën Shkencore</i>

	<i>të Fakultetit në ndihmë të stafit akademik për të realizuar punime dhe kërkime shkencore të nevojshme për avancimin e tyre në karrierë dhe për të pasuruar dhe përditësuar literaturën e lëndëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	GVJ vlerëson se programi i integruar i studimeve në Drejtësi ka përcaktuar format e mësimdhënies dhe mësimnxënies në përputhje me kërkesat akademike. Format kryesore të mësimdhënies përfshijnë leksionet dhe seminarët, të cilat janë të koordinuara me procesin e mësimnxënies, duke mundësuar që studentët të përvetësojnë dijet dhe aftësitë e nevojshme përmes detyrave të kursit, projekteve, provimeve dhe debateve akademike. Në kuadër të programit, janë të përfshira edhe forma të tjera mësimdhënieje ushtrimet për raste gjyqësore, praktikatat profesionale dhe klinike, si dhe orët e hapura. Të gjitha këto mundësojnë zhvillimin e shprehive dhe aftësive praktike të studentëve, duke i përgatitur ata për sfidat e profesionit të juristit. Format janë të përcaktuara qartë në rregulloret përkatëse, përfshirë rregulloren e UT-së, dhe programin PIND, ku detajohen aktivitetet formuese. Sipas Rregullores së UT-së por edhe nga intervistat e zhvilluara, aktivitetet mësimore përfshijnë mësimin në auditor (leksione, seminare, laboratorë etj.), studimin individual, si dhe përgatitjen për provime dhe

	tezën e diplomës. Gjithashtu, programi parashikon praktikat profesionale pranë institucioneve publike dhe private, për të mundësuar përvoja reale dhe lidhjen e teorisë me praktikën. Lëndët janë të ndara në dy kategori: 1. lëndë të detyrueshme; 2. lëndë me zgjedhje; Programi i studimeve është i strukturuar për të ofruar një balancë mes orëve të mësimdhënies dhe aktiviteteve të tjera, përfshirë projektet dhe detyrat e kursit, që janë të rëndësishme për zhvillimin e aftësive kërkimore dhe analitike të studentëve. Mësimdhënia është gjithashtu e pasuruar nga aktivitete të tjera si praktikat profesionale dhe angazhimi në projekte kërkimore, që lidhen ngushtë me përfshirjen e studentëve në raste reale dhe zhvillimin e aftësive praktike. Në këtë kuadër GJVJ konstaton se format e mësimdhënies dhe mësimnxënies janë të rregulluara dhe të mbështetura nga një kornizë e qartë rregullatore, e cila garanton cilësinë e procesit mësimor. <i>Evidenca nr. 15 Rregullorja e Programit të Studimit të Integruar të Ciklit të Dytë në Drejtësi</i> <i>Evidenca nr. 16 Plan i mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë Master i Shkencave në Drejtësi.</i> <i>Evidenca nr. 17 Rregullorja e UT-së</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Stafi akademik respekton nevojat e studentëve, duke ofruar metoda dhe mundësi alternative mësimdhënieje. Përdoren metoda interaktive, si diskutime, studime rasti dhe aktivitete praktike, për të angazhuar studentët në procesin mësimor. Në varësi të lëndëve, stafi përdor leksione, seminare dhe ushtrime praktike, për të përmbushur kërkesat e ndryshme të studentëve. Për ata që kanë nevojë të veçanta, ofrohen mundësi shtesë mbështetëse, si orë mbështetëse ose detyra shtesë. <i>Vizita në Institucion;</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e	Institucioni mbështet e promovon bashkëpunimin mes personelit akademik, duke mundësuar shkëmbime eksperiencash dhe pjesëmarrje në programe ndërkombëtare që ofrojnë praktikë më të mira të didaktikës. Pjesëmarrja në këto aktivitete ka si qëllim përmirësimin e metodave të

prishme të të nxënit.	mësimdhënies dhe përputhjen e tyre me kërkesat e avancuara të arsimit dhe tregut të punës. Gjithashtu, institucioni organizon grupe pune për zhvillimin e moduleve mësimore të reja dhe përshtatjen e kurrikulave me kërkesat bashkëkohore. Ky proces siguron përditësimin e kurrikulave dhe përputhjen e tyre me standardet ndërkombëtare, duke mundësuar që studentët të zhvillojnë aftësitë e kërkuara për tregun e punës. Në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, është realizuar riorganizimi i programit të integruar të ciklit të dytë, "Master i Shkencave" në "Drejtësi". Këto ndërhyrje janë brenda kufirit të lejuar prej 20% të ngarkesës totale të programit, në përputhje me kërkesat e VKM nr. 41, datë 24.01.2018 dhe Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor". Ndryshimet e propozuara janë miratuar nga Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës dhe me Vendim Senati të Universitetit të Tiranës dhe përfshijnë: Riorganizimin e lëndës "E Drejtë Europiane" në dy komponentë: "E Drejtë Publike Europiane" dhe "E Drejtë Private Europiane", të ndara në dy semestra të ndryshëm të vitit të katërt, me ngarkesë auditoriale prej 45 orë leksione dhe 15 orë seminare secila, duke ruajtur të njëjtën ngarkesë prej 6 kreditesh për secilën lëndë. Riorganizimi i lëndës "E Drejtë Civile", e cila më parë zhvillohej në një semestër, tani është ndarë në dy semestra të vitit të dytë (I dhe II), me të njëjtën ngarkesë totale por të shpërndarë më racionalisht (45 orë/15 orë për çdo semestër). Futja e lëndës "E Drejtë Agrare" dhe "Psikologji Gjyqësore" si pjesë e përzgjedhjes në semestrin e dytë të vitit të dytë, për të plotësuar përmbajtjen ndërdisiplinore dhe për t'i ofruar studentëve alternativa të zgjeruara akademike. <i>Evidenca nr. 18 Riorganizim programi brenda 20%"</i> <i>Tabela 11</i> <i>Vendim Senati i Universitetit të Tiranës për miratimin e</i>
------------------------------	---



	<i>riorganizimit (evidencë shitesë)</i> <i>Evidenca nr. 29.3 Lista e mobilitetit të stafit akademik në FDUT 2019-2023</i> <i>Evidenca nr. 38 Krijimi i Qendrës Virtuale të Trajnimit në UT, Vendim i Senatit nr.48</i> <i>Evidenca nr. 38.1: Trajnime dhe leksione të zhvilluara nga Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit.</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është i aftë në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, duke përdorur metoda të ndryshme dhe moderne mësimdhënieje. Stafi akademik, i cili përfaqëson ekspertizë dhe profesionalizëm të lartë, punon për të ndihmuar studentët të zhvillojnë aftësi kritike dhe krijuese, duke nxitur mendimin autonom dhe përgjegjësinë personale. Një nga aspekte më të rëndësishme të këtij kriteri është përdorimi i metodave mësimore që vendosin studentin në qendër të procesit mësimor. Personeli akademik i PIND përdor metoda të ndryshme si diskutimet në grup, rastet studimore dhe zgjidhjen e problemeve për të rritur angazhimin e studentëve. Kjo ndihmon studentët të zhvillojnë aftësitë e mendimit kritik dhe të merren me probleme që janë të lidhura drejtpërdrejt me realitetin praktik, duke i përgatitur ata për sfidat që do të hasin në karrierën e tyre profesionale. Në të njëjtën kohë, personeli akademik siguron një mbështetje të vazhdueshme për zhvillimin akademik të studentëve. Ata ofrojnë mentorim dhe udhëzime individuale për të ndihmuar studentët të kapërcejnë vështirësitë dhe të krijojnë strategji për të arritur suksesin akademik. Kjo mbështetje individuale është e domosdoshme për t'u siguruar që çdo student mund të arrijë potencialin e tij maksimal. Stafi akademik është i angazhuar në përmirësimin e vazhdueshëm të praktikave të mësimdhënies përmes feedback-ut të vazhdueshëm së studentëve. Ata përdorin komentet e studentëve për të rregulluar dhe përmirësuar metodat mësimore, duke e bërë mësimin më të efektshëm dhe më të përshtatshëm për nevojat e studentëve. <i>Evidenca Tabela nr. 6 Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit</i> <i>Evidenca Tabela nr. 12 "Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës</i>

	<i>Evidenca nr. 32.2 Përfshirjen e studentëve në gjyqe simuluese</i> <i>Evidenca nr. 4 Kodi i Etikës i UT-së</i> <i>Evidenca nr. 18 Riorganizim programi brenda 20%</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Institucioni ka krijuar mekanizmat/instrumentet e duhur për vlerësimin dhe përmirësimin në vijimësi të programeve të lëndëve dhe programit të studimit në tërësi, përmes sondazheve përkatëse. Nga takimi me përfaqësues të Degës së Sigurimit të Cilësisë pranë Fakultetit të Drejtësisë, u theksua përdorimi i pyetësorëve online si një metodë kyçe për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. Këta pyetësorë, të përgatitur nga autoritete të ndryshme si ASCAL, Universiteti i Tiranës dhe Dega e Sigurimit të Cilësisë, janë të orientuar për mbledhjen e të dhënave mbi përvojën studentore dhe cilësinë e mësimdhënies. Ata mbulojnë aspekte të rëndësishme si përmbajtja e mësimit, angazhimi i studentëve dhe përdorimi i teknologjisë në mësim, duke ndihmuar kështu në përmirësimin e metodologjisë dhe cilësisë së mësimdhënies. Vlerësimet e brendshme dhe pyetësorët ndihmojnë për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë akademike. Autoritetet drejtuese marrin masa për përmirësimin e situatës pas analizës së të dhënave të mbledhura. Pjesë e këtij procesi janë ndryshimet në programin e mësimdhënies dhe rishikimi i kurrikulës. <i>Evidenca nr. 33.6 Vlerësimet e personelit akademik</i> <i>Evidenca nr. 33.8.1 Pyetësori për mësimdhënien online.</i> <i>Evidenca nr. 33.9 Trajtimi i shqetësimeve në mbledhjet e Dekanatit.</i> <i>Evidenca nr. 33.10 Rishikimi i kurrikulës dhe programit të mësimdhënies.</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së	Përmirësimi i vazhdueshëm i procesit akademik realizohet nëpërmjet angazhimit të të gjitha strukturave akademike, ndihmës-akademike dhe administrative. Stafi akademik trajnohet rregullisht për të përvetësuar dhe zbatuar metoda bashkëkohore të mësimdhënies, të përshtatura sipas specifikave të çdo programi studimi. Këto aktivitete janë organizuar në format online dhe fizik, duke trajtuar tema që lidhen me metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies, përdorimin e teknologjisë në auditore, zhvillimin e kompetencave digjitale, si dhe aftësimin për menaxhimin

mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	efektiv të procesit akademik. Trajnimet dhe shkëmbimet ndërkombëtare për stafin akademik, si Erasmus+ dhe KAI, janë pjesë e mundësive që ofrohen për zhvillimin e aftësive didaktike dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Personeli ka gjithashtu mundësi të marrë pjesë në trajnime të organizuara nga ekspertë të ftuar dhe njësi të specializuara, duke siguruar mbështetje për përdorimin e metodave më të fundit të mësimdhënies. <i>Evidenca nr. 29.3 Lista e mobilitetit të stafit akademik në FDUT 2019-2023"</i> <i>Evidenca nr. 33 Urdhër për ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë</i> <i>Evidenca nr. 33.2 Plan veprimi i KSBC-së" -</i> <i>Evidenca nr. 38.1 Trajnimet dhe Leksionet e zhvilluara nga Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit</i>			
Konkluzione	<i>Stafi akademik i kualifikuar i PIND përdor metoda bashkëkohore të mësimdhënies që vendosin studentin në qendër të procesit, si diskutimet në grup, analizat e rasteve dhe zgjidhja e problemeve, për të nxitur mendimin kritik dhe angazhimin aktiv.</i> <i>Këto qasje ndihmojnë studentët të zhvillojnë aftësi praktike dhe intelektuale, duke i përgatitur ata për sfidat e karrierës profesionale. Institucioni, përmes njësive dhe zyrave përkatëse, ofron trajnime të vazhdueshme për stafin akademik në lidhje me përdorimin dhe aplikimin e metodave interaktive dhe dixhitalizuara të mësimdhënies.</i> <i>Këto trajnime mundësojnë që personeli akademik të zhvillojë aftësitë e nevojshme për të ofruar një mësimdhënie më efektive dhe të përditësuar, duke i mundësuar studentëve një përfitim sa më të mirë të njohurive dhe aftësive të kërkuara në auditor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

40

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstaton se kriteret dhe mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore, të përcaktuara në Rregulloret përkatëse të programit të studimit dhe të institucioneve, janë të detajuara dhe të strukturuar në një mënyrë që siguron transparencë dhe mundësi të barabarta për të gjithë studentët. Në përputhje me praktikën më të mirë të menaxhimit të procesit mësimor dhe vlerësues, institucioni ka siguruar që të gjitha procedurat dhe kriteret e vlerësimit, përfshirë ato për organizimin e grupeve mësimore, frekuentimin e orëve, vlerësimin lëndëve, riprovimet, dhe mundësitë për ankimimin e provimeve, janë transparente dhe të qarta për studentët. Gjithashtu, GVJ vëren se mundësia e mbështetjes dhe këshillimit të vazhdueshëm përmes Zyrës së Karrierës është një hap i rëndësishëm që mundëson mbështetje të nevojshme për studentët, duke u ofruar atyre mundësinë për të adresuar çdo çështje që mund të lindë gjatë procesit akademik dhe vlerësues. <i>Evidenca nr. 15 Rregullorja e programit të studimi të integruar te ciklit të dytë në Drejtësi</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ, gjatë takimeve të zhvilluara me grupet e interesit dhe gjatë shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, konstaton se në fillim të çdo lënde apo moduli, studentët njihen me përmbajtjen e planprogramit (syllabusit), i cili prezantohet nga titullari i lëndës. Syllabuset përmbajnë informacion të plotë dhe të strukturuar mbi: objektivat mësimorë të lëndës, përmbajtjen tematike javore, metodologjinë e mësimdhënies, literaturën e detyrueshme dhe ndihmëse, mënyrat e vlerësimit dhe peshën relative të secilës komponentë të vlerësimit. <i>Evidenca nr. 20 Syllabuset</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në formë dhe mënyra të	GVJ, pas shqyrtimit të evidencave të vëna në dispozicion dhe gjatë takimeve me stafin akademik, konstaton se testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive të studentëve në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë në Drejtësi realizohet në përputhje me parimet e përcaktuara në



ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	dokumentacionin institucional dhe në praktikë reflekton një qasje të shumëllojshme dhe gjithëpërfshirëse. Bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit, vlerësimi ndahet në komponentë të ndryshëm, duke përfshirë: • provime të ndërmjetme dhe përfundimtare; • detyra kursi; • prezantime; • puna praktike me raste gjyqësore; • seminare; • dhe angazhimin individual të studentit në procesin mësimor; GVJ vlerëson se kjo larmi formash u jep studentëve mundësinë të shfaqin njohuritë dhe kompetencat e tyre në mënyra të ndryshme, në përputhje me tipologjinë e lëndës. Kështu, në lëndët teorike theksi vihet në përvetësimin e koncepteve bazë përmes eseve dhe provimeve me shkrim, ndërsa në lëndët praktike si klinika ligjore, rëndësi merr analiza e rasteve konkrete dhe ndërveprimi aktiv i studentëve në situata të simuluar. Nga intervistat me stafin dhe nga materialet e shqyrtuara rezulton se pedagogët kanë autonomi për të zgjedhur format më të përshtatshme të vlerësimit për lëndën që mbulojnë, duke ruajtur koherencën me rezultatet e të nxënit të parashikuara në syllabus. <i>Evidenca nr. 20 Syllabuset</i> <i>Evidenca nr. 15 Rregullorja e programit të studimi të integruar te ciklit të dytë në Drejtësi</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se përmbajtja dhe mënyrat e vlerësimit të studentëve janë të qarta, të dokumentuara në rregulloret përkatëse dhe të komunikuar në mënyrë të rregullt përmes syllabus-it. Studentët njihen që në fillim me format e testimit dhe vlerësimit, të cilat janë të shumëllojshme dhe të përshtatura sipas natyrës së lëndës. Vlerësimi zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme dhe shërben si mjet për të nxitur të nxënit aktiv, për të matur objektivisht njohuritë dhe për të ndjekur progresin.			
Shkalla e përmbushjes së	Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet



standardit		kryesisht	plotësisht
			X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ konstaton se procesi i testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit akademik dhe është i strukturuar qartë në dokumentet rregullatore të institucionit, të cilat përcaktojnë qartë procedurat, kalendarin e provimeve dhe komponentët përbërës të vlerësimit, të cilët janë të njohur për stafin akademik dhe studentët. Në përputhje me parimin e kontrollit të vazhdueshëm, nota përfundimtare e studentit përbëhet nga disa komponentë që evidentohen në mënyrë të qartë në syllabus-in e secilës lëndë/modul. Këta komponentë përfshijnë: - provimin e ndërmjetëm; - diskutimet në seminare; - detyrat e kursit dhe praktikat; - provimin përfundimtar; Kjo metodologji synon të pasqyrojë një vlerësim gjithëpërfshirës dhe objektiv, duke balancuar elementët teorikë me ata praktikë dhe duke nxitur angazhimin e vazhdueshëm të studentëve gjatë gjithë semestrit. Gjithashtu, institucioni ka përcaktuar përgjegjësitë për monitorimin e zbatimit të këtyre procedurave përmes njësive dhe grupeve të veçanta monitorimi, çka dëshmon për një qasje të qëndrueshme dhe të strukturuar në menaxhimin e procesit të vlerësimit. <i>Evidenca nr. 20 Model syllabusi</i> <i>Evidenca nr. 15 Rregullorja e programit të integruar të ciklit të dytë në Drejtësi</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në	Institucioni ka ndërmarrë hapa konkretë drejt modernizimit të

zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	procesit të vlerësimit të studentëve, duke integruar sisteme elektronike që sigurojnë transparencë, objektivitet dhe integritet akademik. Përdorimi i këtyre sistemeve është bërë në mënyrë të kujdesshme dhe të përshtatur me natyrën e lëndëve, duke i lejuar ato të përdoren aty ku është teknikisht dhe pedagogjikisht e mundur. Në këtë drejtim është aplikuar sistemi elektronik i vlerësimit “Clean Scoring”, i zhvilluar dhe zbatuar në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF). Ky sistem përfaqëson një praktikë bashkëkohore që synon të minimizojë ndikimet subjektive dhe të eliminojë çdo mundësi për abuzim apo manipulim në procesin e notimit, duke ofruar një korrigjim të automatizuar, të pavarur dhe të mbrojtur, “Clean Scoring” përforcon besueshmërinë e rezultatit final. <i>Evidenca nr. 20.2: Sistemi “Clean Scoring”</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi ka përgjegjësinë për vlerësimin e studentëve në përputhje me komponentët e përcaktuar në syllabuset e lëndëve përkatëse. Metodat e vlerësimit dhe format e kontrollit të dijeve u bëhen të njohura studentëve që në fillim të çdo semestri, përmes syllabusit të çdo lënde si dhe informacionit të dhënë nga pedagogët dhe stafi administrativ. Kjo siguron transparencë dhe orientim të qartë për studentët gjatë gjithë procesit mësimor. I gjithë procesi i vlerësimit zhvillohet në përputhje me standardet akademike dhe parimet e përcaktuara nga kuadri ligjor për arsimin e lartë si dhe udhëzimet përkatëse institucionale, duke garantuar korrektësi, transparencë dhe barazi për të gjithë studentët. <i>Evidenca 20.Syllabus-et;</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në	Stafi akademik siguron që çdo vlerësim të shoqërohet me komente sqaruese, sidomos në detyrat e kursit dhe testimet, për të ndihmuar studentët të kuptojnë pikat e forta dhe dobësitë e tyre. Studentët informohen për rezultatet dhe kanë të drejtë të njihen me mënyrën e vlerësimit, përmes konsultimeve individuale apo seancave sqaruese. Kjo praktikë ndihmon në përmirësimin e vazhdueshëm dhe krijimin e një marrëdhënieje bashkëpunuese pedagog-student. Sipas rregullores së programit të studimit (neni 27) korrigjimi



të ardhmen.	bëhet brenda 10 ditëve pune nga dita e zhvillimit të provimit. <i>Evidenca 15. Rregullorja e Programit të Studimi të Integruar të Ciklit të Dytë në Drejtësi;</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik zbatojnë Kodin e Etikës së UT-së (<i>Evidenca nr. 4, neni 3</i>), duke ndaluar çdo formë plagjiature apo kopjimi në provime, detyra apo tema diplome. Studentët janë të detyruar të respektojnë këto rregulla, përfshirë ndalimin e përdorimit të celularëve dhe materialeve ndihmëse gjatë provimeve. Provimet monitorohen nga të paktën dy pedagogë të caktuar nga Departamenti, sipas Rregullores së Programit. Në rast shkeljesh, studenti i nënshtrohet procedurës disiplinore sipas rregullores dhe rasti shqyrtohet nga një komision etik në nivel fakulteti. Në rregulloren e programit të studimit (<i>neni 30</i>) janë përcaktuar rregullat e provimeve si: - Në sallën e provimit nuk lejohet përdorimi i materialeve që gjykohen sit të tilla nga pedagogu i lëndës përkatës, i cili përpara fillimit të provimit citon materialet që lejohen të përdoren gjatë kohës së zhvillimit të provimit; - Cdo komunikim i studentit në sallën e provimit është i ndaluar dhe sjell ulje të pikëve në vlerësimin përfundimtar; - Nëse komunikimi përsëritet student mund të përjashtohet nga provimi; <i>Evidenca nr. 3 Rregullorja e UT-së</i> <i>Evidenca nr. 4 Kodi i Etikës i UT-s</i> <i>Evidenca nr. 15 Rregullorja e programit të studimi të integruar të ciklit të dytë në Drejtësi;</i> <i>Evidenca nr. 33.5.1;</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Nga evidencat e shqyrtuara rezulton se procesi i vlerësimit zhvillohet mbi bazën e meritës dhe respekton afatet kohore. Rezultatet e provimeve shpallen brenda 10 ditëve pune, ndërsa ato të riprovimeve brenda 7 ditësh pune. Fletët e provimit firmosen nga pedagogu hartues dhe vlerësimi bëhet i detajuar sipas pikëve për çdo pyetje. Njoftimi për zgjidhjen e tezës dhe shpallja e rezultateve bëhet zyrtarisht duke siguruar transparencë dhe drejtësi në vlerësim.

	<i>Evidenca nr. 3 Rregullorja e UT-së;</i> <i>Evidenca nr. 15 Rregullorja e programit të studimi të integruar të ciklit të dytë në Drejtësi;</i>			
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Nga evidencat e shqyrtuara rezulton se institucioni garanton të drejtën e studentëve për sqarim dhe ankimim të vlerësimit. Studentët mund të kërkojnë sqarim nga pedagogu, të shohin kopjen e provimit dhe, në rast mosmarrëveshjeje, të kërkojnë ngritjen e komisionit të rivlerësimit. Procesverbalet dorëzohen brenda 2 ditëve nga trajtimi i kërkesave. Pas shpalljes së rezultateve, nuk lejohet ndryshim i vlerësimit nga pedagogu, çka garanton transparencë, objektivitet dhe besueshmëri në vlerësim. <i>Evidenca nr. 15 Rregullorja e programit të studimi të integruar të ciklit të dytë në Drejtësi;</i>			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	E drejta e ankimimit është e përcaktuar në rregulloren e pogramit të studimit (neni 28). Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimin. Ankesa paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 48 orëve nga marrja dijeni e rezultatit të provimit. GVJ konstaton se procedurat për ankimim janë të qarta dhe respektojnë afatet e përcaktuara. Komisionet ad hoc ngrihen brenda 3 ditëve për të verifikuar ankimin dhe për të përcaktuar vlerësimin përfundimtar. Procesi është transparent dhe i dokumentuar, duke garantuar që të drejtat e studentëve për rishikimin e rezultateve janë të mbrojtura. <i>Evidenca nr. 15 Rregullorja e programit të studimi të integruar të ciklit të dytë në Drejtësi;</i>			
Konkluzione	<i>Dokumentet dhe procedurat e vlerësimit dhe ankimimit janë të qarta dhe të detajuara, duke siguruar transparencë në procesin e vlerësimit, duke u respektuar afatet.</i> <i>Gjithashtu duke garantuar që të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimet e për të kërkuar rishikim janë të mbrojtura në përputhje me rregulloret dhe procedurat e përcaktuara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe evidencave, GVJ konstaton se programi i studimit është konceptuar për të garantuar thellim akademik, zhvillim profesional dhe aftësi kërkimore. Në aspektin akademik, ai mbulon të gjitha fushat themelore dhe ndërdisiplinore të së drejtës, me një kombinim të balancuar lëndësh të detyrueshme dhe me zgjedhje. Plani mësimor është në përputhje me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (EQF). Elementet praktik përfshin metoda aktive si gjyqe të simuluar praktikë profesionale dhe bashkëpunim me institucione publike/private. Në fushën kërkimore, studentët përfshihen në projekte të udhëhequra nga pedagogët dhe udhëhiqen në hartimin e tezës. Gjithashtu, programi mbështet orientimin profesional dhe akademik të studentëve përmes mentorimit, anketimeve të cilësisë dhe mundësive të shkëmbimit ndërkombëtar. <i>Evidenca nr. 1.1 Plani mësimor i programit PIND).</i> <i>Evidenca nr. 32.2 Përfshirja e studentëve në gjyqe të simuluar</i> <i>Evidenca nr. 0.1/22, Tabela nr. 22 Studentë të angazhuar në takime dhe aktivitete të realizuara 2019–2024</i> <i>Evidenca nr. 32.1 Klinika e Ligjit dhe Lista e Marrëveshjeve.</i> <i>Evidenca nr. 23.1 – Udhëzimi për temën e diplomës</i> <i>Evidenca nr. 24.1 – Anketimi i studentëve për vlerësimin e cilësisë</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	GVJ konstaton se programi i studimit përfshin lëndë dhe module që nxisin zotërimin e teknologjisë së informacionit si: - “E Drejta Penale Informatike”; - “Siguria Kibernetike”; - “E Drejta e Pronësisë Intelektuale”; - trajnime praktike për përdorimin e platformave dixhitale dhe mjeteve për menaxhimin e dokumenteve ligjore si Projekti i financuar nga AKKSHI për monitorimin e vendimeve të GJK; Në aspektin human dhe social, lëndë si: - “Etika Ligjore”;

	- "Filozofia e së Drejtës"; të cilat i pajisin studentët me aftësi për të analizuar kontekstin social dhe moral të çështjeve ligjore, ndërsa përfshirja në klinikën ligjore dhe projektet komunitare ndihmon në zhvillimin e ndërgjegjësimit shoqëror. Komunikimi dhe ndërveprimi përforcohen përmes simulimeve gjyqësore, debatit dhe lëndëve dedikuara si "Komunikimi Ligjor" dhe "Arti i Debatit", duke zhvilluar aftësi për argumentim, negocim dhe ndërveprim profesional në situata të ndryshme. Gjithashtu, programi mbështet zhvillimin e aftësive ndërkulturore dhe shumëgjuhëshe përmes pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare. GVJ vlerëson se programi u ofron studentëve një formim të plotë dhe bashkëkohor, duke i përgatitur si profesionistë të aftë, etikë dhe konkurrues në një treg pune të globalizuar. <i>Evidenca nr. 29.5.1 – Projekti për monitorimin e vendimeve të GJK.</i> <i>Evidenca nr. 32.1 – Raporti i Klinikës Ligjore.</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Syllabuset e lëndëve paraqesin përshkrimin e temave dhe lëndëve, numrin e krediteve, etj, dhe me rëndësi të veçantë është përshkrimi i objektivave të lëndës. Çdo lëndë ka objektivat e saj në lidhje me kompetencat që duhet të arrijnë studentët në fund të lëndës së zhvilluar dhe është në lirinë akademike të pedagogëve të zgjedhin metodologjinë dhe format më të mira të arritjes së tyre. Për këtë arsye syllabuset analizohen dhe shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme në funksion të rezultateve sa më të mira të studentëve e konkulduar kjo në rezultatin e provimeve, punësimin e studentëve dhe opinionin e vet studentëve në fund të përfundimit të lëndës. Pedagogët në orën e parë të leksionit njohin studentët me syllabusin e lëndës, me objektivat, temat, të drejtat dhe detyrimet, format e vlerësimit, etj, si dhe orientojnë studentët me anë të konsultimeve drejt çështjeve më të rëndësishme si në zhvillimin e provimit të lëndës, ashtu edhe në detyrimet përmbyllëse. <i>Evidenca 20.Syllabus-et;</i> <i>Evidenca 15. Rregullorja e Programit të Studimi të Integruar të Ciklit të Dytë në Drejtësi;</i>

Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Stafi akademik i përfshirë në këtë program promovon një angazhim të vazhdueshëm të studentëve gjatë procesit mësimor, duke garantuar përmbushjen e objektivave të lëndëve përmes metodave interaktive dhe të orientuara drejt zbatimit praktik të njohurive të fituara (siç dëshmohet nga procesverbalet e mbledhjeve të GVJ). Struktura kurrikulare është ndërtuar në përputhje me programet studimore të ngjashme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke favorizuar mobilitetin studentor. Gjithashtu, institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me universitete partnere, të cilat krijojnë mundësi për shkëmbime akademike dhe përvoja ndërinstitucionale. <i>Megjithatë, GVJ rekomandon nevojën për shfrytëzimin më të plotë të marrëveshjeve ekzistuese dhe zgjerimin e rrjetit të bashkëpunimeve, duke patur parasysh e numrit e studentëve dhe nevojën për diversifikim të mundësive praktike dhe kërkimore.</i>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik, përfshirë ata me kontratë, organizon rregullisht orë të hapura dhe seminare që pasqyrojnë zhvillimet më të fundit brenda dhe jashtë programit të studimit. Këto aktivitete pasurojnë përmbajtjen e lëndëve dhe përgatitin studentët për sfidat profesionale. Leksionet e hapura, të mbajtura nga pedagogë dhe ekspertë të jashtëm, përfshijnë tema bashkëkohore si dixhitalizimi, siguria kibernetike, dhe përdorimi i teknologjive moderne në drejtësi. Kjo e ndihmon studentët të zhvillojnë aftësitë analitike dhe të përgatiten për tregun e punës. <i>Evidenca nr. 26 Lista e publikimeve të stafit akademik.</i> <i>Evidenca nr. 22 Leksione të hapura</i> <i>Evidenca nr. 29.9 Takime me partnerë dhe bashkëpunëtorë</i>
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	FD nxit zhvillimin e ideve inovative dhe kërkimin shkencor të avancuar nga studentët përmes një sërë mekanizmash dhe aktiviteteve të strukturuar. Fakulteti organizon Konferenca Studentore, të cilat u japin mundësi studentëve të prezantojnë punimet e tyre kërkimore në fusha të ndryshme të së drejtës, duke u vlerësuar nga stafi akademik dhe përfaqësues të



	institucioneve partnere. Po ashtu, organizimi i gjyqeve simuluese shërben si një platformë ndërveprimi praktik dhe stimulon të menduarit kritik dhe argumentimin juridik. Për më tepër, përmes bashkëpunimit me organizatën ELSA Albania, studentët përfshihen në aktivitete, të cilat inkurajojnë ndërkombëtarizimin e kërkimit dhe zhvillimin personal e profesional. Fakulteti mbështet edhe grupet kërkimore studentore, të cilat punojnë mbi çështje aktuale juridike nën mentorimin e pedagogëve, si dhe siguron mbështetje financiare për pjesëmarrjen në konferenca, publikime ose aktivitete me karakter shkencor. <i>Evidenca nr. 6 Plani Strategjik për Kërkimin Shkencor të UT-së;</i> <i>Evidenca nr. 31 Konferencë Studentore</i> <i>Evidenca nr. 32.2 Përfshirja e studentëve në gjyqe simuluese</i> <i>Evidenca nr.43 Thirrje për studentët për pjesëmarrje në grupet kërkimore</i>			
Konkluzione	<i>Duke u bazuar në gjetjet dhe evidencat e evidentuara, GJV konkludon se institucioni ka bërë përpjekje të konsiderueshme për të siguruar përmbushjen e standardeve të përcaktuara për mësimdhënien dhe mbështetje për studentët.</i> <i>Organizimi i mësimdhënies mbi bazën e kompetencave dhe zhvillimi i aftësive praktike dhe profesionale, mbështetje për kërkimet shkencore, si dhe integrimi i studentëve në projekte kërkimore janë elemente të rëndësishme që janë të pranishme dhe janë mbështetur nga institucioni.</i> <i>Megjithatë, rekomandohet që angazhimi në kërkime të avancuara dhe përfshirja aktive e studentëve duhet të rritet për të siguruar një zhvillim më të thelluar të aftësive shkencore dhe profesionale të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

50

Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Duke u bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe analizat e kryera, mund të konkludohet se institucioni ka zhvilluar një procedurë të qartë dhe të detajuar për përmbylljen e detyrimeve përmbyllëse, veçanërisht për mbrojtjen e diplomës. Procedura është e përcaktuar në Rregulloren e UT-së dhe Rregulloren e programit PIND, duke siguruar një udhëzues të detajuar për punimin dhe mbrojtjen e temës së diplomës. Punimi i diplomës është një komponent i integruar i programit të studimeve të ciklit të dytë dhe parashikon 12 kredite ECTS. Udhëzuesi për punimin e diplomës është i miratuar dhe mbështet studentët përmes udhëzimeve për shkrimin, citimin dhe strukturimin e punimit. Procedura është publike dhe e njohur për studentët, duke siguruar një nivel të lartë transparence dhe qartësie në lidhje me detyrimet përmbyllëse të programit. <i>Evidenca 15. Rregullorja e Programit të Studimi të Integruar të Ciklit të Dytë në Drejtësi;</i> <i>Evidenca 3. Rregullorja e UT-së;</i> <i>Evidenca 23.1 Udhëzimi i Temës së Diplomës;</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Bazuar në rregulloret përkatëse dhe dokumentacionin mbështetës, rezulton se struktura përgjegjëse dhe personeli akademik në FDUT ofrojnë mbështetje të rregullt dhe të dokumentuar për studentët gjatë përgatitjes së detyrimeve përmbyllëse. Procedurat për caktimin e temave të diplomës, kriteret për përzgjedhjen e drejtuesve, si dhe afatet dhe sezonet e mbrojtjes janë të përcaktuara qartë në rregullore dhe i bëhen të njohura studentëve në kohë të përshtatshme. Departamentet luajnë rol kyç në shpërndarjen e temave, caktimin e udhëheqësve dhe dhënien e udhëzimeve të nevojshme për përgatitjen e punimit. Kjo mbështetje vjen në përputhje me normat akademike dhe siguron që studentët të kenë akses në informacione dhe burime të nevojshme për përmbylljen me sukses të detyrimeve përmbyllëse. <i>Evidenca 23.1 Udhëzimi i Temës së Diplomës;</i> <i>Evidenca 23.2 Shembull shpërndarje temat e diplomave</i> <i>Manual për përgatitjen e temës së diplomës(evidencë shtesë)</i>

Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë (PIND), detyrimi përmbyllës i studentëve realizohet në formën e mbrojtjes së punimit të diplomës, siç parashikohet në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Për këtë arsye, nuk aplikohet një provim final në formën e testimit të njohurive nga të gjitha lëndët/modulet gjatë viteve akademike. <i>Evidencë Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Rregulloret tregojnë se pedagogët udhëheqës luajnë një rol të strukturuar dhe aktiv në të gjitha fazat e përgatitjes së punimit të diplomës – që nga përcaktimi i temës, deri në orientimin metodologjik dhe miratimin përfundimtar të punimit për paraqitje para komisionit. Udhëzuesi i miratuar për përgatitjen e temës së diplomës ofron qartësi dhe standarde të unifikuara për procesin. <i>Evidenca nr. 23.1 Udhëzimi i Temës së Diplomës;</i> <i>Manual për përgatitjen e temës së diplomës (evidencë shtesë)</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në praktikë, FDUT-ja ofron mbështetje funksionale dhe fleksibile për studentët, në varësi të fushës dhe temës së studimit, duke i ndihmuar ata për të realizuar matje, analiza apo kërkime në terren, si brenda ashtu edhe jashtë institucionit. Përmes seancave metodologjike, pedagogu udhëheqës orienton studentin në aspektet praktike dhe metodologjike të përpunimit të të dhënave. Gjithashtu, institucioni përdor mekanizma administrativë mbështetës, si shpërndarja e pyetësorëve dhe lëshimi i vërtetimeve për mbledhjen e të dhënave jashtë institucionit. <i>Evidenca nr. 23.1 Udhëzimi i Temës së Diplomës;</i> <i>Manual për përgatitjen e temës së diplomës (evidencë shtesë)</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të	Vlerësimi i punimeve të diplomës bëhet me notë, dhe kjo notë është një mesatare e vlerësimeve të anëtarëve të Komisionit të

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

52

përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Vlerësimi. Për më tepër, rezultati përfundimtar shënohet në procesverbal dhe bëhet publik në fund të çdo seance mbrojtjeje. Ky proces siguron transparencë dhe qartësi për studentët, të cilët janë të informuar menjëherë pas përfundimit të mbrojtjes për rezultatet e punimeve të tyre. <i>Evidenca 15. Rregullorja e Programit të Studimi të Integruar të Ciklit të Dytë në Drejtësi;</i> <i>Evidenca nr. 23.1 Udhëzimi i Temës së Diplomës;</i> <i>Manual për përgatitjen e temës së diplomës (evidencë shtesë)</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Diplomat janë të miratuara dhe të regjistruara në regjistrin shtetëror të diplomave për arsimin e lartë, duke siguruar verifikueshmërinë dhe transparencën e procesit. UT pajis studentët me diplomën ose certifikatën dhe suplementin e diplomës. Institucioni nuk ofron mundësinë për lëshimin e dublikateve por vërtetim të barazvlefshme me diplomën. Ky proces është i qartë në aktet e brendshme rregullatore të Institucionit. <i>Evidenca nr.2 Rregullorja e UT-së (nenet 70-72)</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Institucioni respekton legjislacionin në fuqi për sa i përket ruajtjes dhe arkivimit të dokumentacionit të studentëve pas përfundimit të studimeve. Dokumentet e regjistrimit të studentëve ruhen për një periudhë pa afat, dhe institucioni ka një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, që përpunon dhe përdor për qëllime të ndryshme, përfshirë kërkesat e ministrisë për arsimin dhe Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë. Kjo mundëson një menaxhim efikas të informacionit dhe ndihmon në përmbushjen e kërkesave ligjore dhe të politikave institucionale. <i>Evidenca nr.2 Rregullorja e UT-së</i> <i>Evidenca nr.40 Rregullorja "Për Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale në UT"</i>
Konkluzione	<i>Institucioni ka zhvilluar një procedurë të detajuar dhe të standardizuar për realizimin e detyrimeve përmbyllëse të studentëve, në përputhje me rregulloret institucionale dhe legjislacionin në fuqi. Mbrojtja e temës së diplomës zëvendëson provimin përfundimtar dhe është e integruar në program me 12 kredite ECTS. Studentët marrin udhëzime të strukturuar nga pedagogët udhëheqës që nga përzgjedhja e</i>

	<i>temës e deri në finalizimin e punimit.</i> <i>Manuali i diplomës dhe udhëzuesit përkatës ofrojnë standarde të qarta për përgatitjen, shkrimin dhe paraqitjen e temës. Procesi i vlerësimit të temës së diplomës kryhet nga një komision dhe është i dokumentuar me procesverbal. Diplomat dhe suplementet lëshohen sipas rregullave përkatëse dhe regjistrohen në regjistrin shtetëror të diplomave.</i> <i>UT respekton afatet dhe detyrimet për ruajtjen e dokumentacionit akademik të studentëve dhe garanton mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me kuadrin ligjor përkatës.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	N / A
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të	N / A

njohurive dhe kompetencave profesionale.				
Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	N / A			
Konkluzione	<i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:</i> <i>Kriteret e lidhura me këtë standard janë të pa aplikueshme për këtë program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të	Arritjet akademike dhe shkencore të personelit akademik, edhe efektiv edhe me kontratë, si dhe të personelit ndihmës akademik përmbushin dukshëm standardet dhe kriteret e domosdoshme normative përkatëse për ushtrimin e profesionit si dhe për realizimin me sukses të objektivave profesionale

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

55

studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

dhe akademike të programit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, (Tabela Përmbledhese 6) për realizimin e programit të ciklit të dytë të studimit Msc (PI) në Drejtësi, janë angazhuar staf akademik në tre vite akademike si më poshtë:

1. Për vitin akademik 2022- 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 147 pedagogë nga të cilët 87 PAE dhe 60 PAK (60 % / 40 %);
2. Për vitin akademik 2023- 2024 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 147 pedagogë nga të cilët 93 PAE dhe 54 PAK (64% / 36 %);
3. Për vitin akademik 2024 - 2025 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 128 pedagogë nga të cilët 91 PAE dhe 37 PAK (72% / 28 %):

Kualifikimi i stafit mësimdhënës në këto tre vite paraqitet si më poshtë vijon:

Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	15	1	15	1	15	-
Prof. Asoc.	23	6	33	7	36	7
Dr./PhD	34	21	26	31	22	13
Msc (proc Dr)	15	32	19	15	18	17
Totali	87	60	93	54	91	37

Nga sa më sipër rezulton se në procesin e mësimdhënies të programit të studimit të ciklit të dytë Msc në Drejtësi, janë angazhuar edhe staf akademik me Msc (të gjithë në process doktorature).

GVJ sugjeron që në këtë program studimi, stafi mësimdhënës të ketë të paktën gradën DR, në përmbushje të kërkesave ligjore në fuqi.

	<i>Evidenca tabelat 6;</i>
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Bazuar në të dhënat statistikore të vendosura në dispozicion në tabelat bashkëlidhur RVB, konstatohet se programi i studimit Master i Shkencave në Drejtësi plotëson kërkesat ligjore në fuqi në lidhje me ngarkesën e personelit akademik. Në përputhje me VKM nr. 418, datë 10.05.2017, rezulton se në vitin akademik 2024-2025, personeli akademik efektiv (PAE) ka mbuluar 74% të ngarkesës mësimore, siç parashikohet nga kuadri ligjor përkatës. Gjithashtu, ngarkesa është e shpërndarë në përputhje me fushat e kualifikimit dhe ato kërkimore të stafit akademik, duke reflektuar përputhje të ndërmjet ekspertizës së personelit akademik dhe objektivave të programit. <i>Evidenca tabelat 1, 4, 6, 7,8, 19</i> <i>Evidenca nr. 26</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar pranë programit të studimit Msc në Drejtësi. Kontratat e punësimit pranë UT dhe mbulimi me sigurime shoqërore dhe shëndetësore janë realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. PAE dhe PAK i angazhuar në këtë program studimi pothuaj nuk ka ndryshuar. Mbi 90% e stafit akademik është i angazhuar gjatë të pestë viteve akademike. <i>Evidenca tabelat 6;</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të	Kuadri i paraparë normativ për procedurën e rekrutimit të personelit në institucion është i qartë, i parashikueshëm dhe objektiv. GVJ konstaton se kontratat e punës për personelin akademik janë hartuar në përputhje me Kodin e Punës dhe legjislacionin specifik për arsimin e lartë, duke garantuar transparencë dhe rregullshmëri në marrëdhëniet e punës. Për personelin akademik efektiv me grada dhe tituj, kontratat kalojnë nga afatshkurtra në paafat pas periudhës njëvjeçare, ndërsa për personelin pa grada dhe atë me kohë të pjesshme, kontratat mbeten njëvjeçare. Ngarkesa mësimore dhe trajtimi financiar përcaktohen sipas akteve nënligjore dhe vendimeve

studimit.	të Bordit të Administrimit të UT-së. <i>Evidenca 1, 36, 36.1, 38, 38.1</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Institucioni qeveriset nga një kuadër i avancuar normativ referuar angazhimit të personelit ndihmës akademik në realizimin e programit. GVJ konstaton pas vizitës në institucion se Fakulteti i Drejtësisë disponon dy laboratorë funksionalë – Laboratorin e Kriminologjisë dhe atë të Klinikës Ligjore – me një sipërfaqe totale prej 80 m ² , të pajisur dhe të mirëmbajtur nga 3 laborante dhe një punonjëse ndihmësakadematike. Laboratori i Kriminologjisë është nën drejtimin e Departamentit Penal, ndërsa Klinika Ligjore funksionon si njësi ndërdisiplinore, duke përmbyllur kërkesat për mjedise të dedikuara për mësim dhe praktikë profesionale.
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Institucioni posedon një sistem të qartë, të saktë si dhe të përditësuar për të dhënat e personelit akademik efektiv dhe të angazhuar me kontratë, si dhe të personelit ndihmës akademik për secilin vit akademik. GVJ konstaton se të dhënat e personelit akademik ruhen dhe përditësohen në mënyrë të rregullt nga Zyra e Burimeve Njerëzore, përmes dosjeve individuale për çdo pedagog me kohë të plotë apo të pjesshme, të cilat përmbajnë dokumentacionin përkatës. Gjithashtu, çdo departament mban evidencë të realizimit të ngarkesës mësimore për secilin semestër, siç rezultoi nga shqyrtimi i dosjeve gjatë vizitës në institucion. <i>Evidenca 37.1. Model Dosje Individuale të Stafit Akademik;</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në	Institucioni ka në dispozicion një personel të mjaftueshëm sipas secilit standard për realizimin e programit në tërësi. Institucioni ka edhe disa marrëveshje të vlefshme dhe të dobishme me disa institucione të tjera për realizimin me sukses të programit. Fakulteti ka burimet e nevojshme njerëzore për të mundur mbështetjen dhe asistencën ndaj studentëve në veprimtaritë në funksion të programit të studimit. Zhvillimi i praktikës profesionale, është një ndër lëndët e detyrueshme në

praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	kurrikulën e këtij program studimi. Për të mundësuar realizimin e praktikave profesionale në këtë program studimi janë lidhur marrëveshjet e bashkëpunimit me një sërë institucionet publike dhe private. Bazuar në këto marrëveshje, studentëve u mundësohet logjistika dhe mbështetja e nevojshme në zhvillimin e praktikave dhe ofrimi i eksperiencës në fusha të caktuara të ligjit. <i>Evidenca 32. Dokumentacioni mbi Praktikën Mësimore 2024-2025;</i>
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Programi i studimit Master i Shkencave në Drejtësi ka pjesë të kurrikulës zhvillimin e praktikës profesionale. Në përfundim të praktikës mësimore, bazuar në <i>nenin 66</i>, të rregullores së UT, studenti përgatit një relacion për punën e kryer, e cila vlerësohet nga personeli akademik që drejton praktikën, pasi merr edhe mendimin e punonjësit të caktuar përgjegjës, në institucionin ku ajo është kryer. Vlerësimi bëhet sipas kërkesave në planin mësimor. Për praktikën mësimore/profesionale, në përbërje të programeve të lëndëve të caktuara, kjo notë përfshihet në vlerësimin përfundimtar të lëndës përkatëse. <i>Evidenca 3. Rregullorja e UT-së;</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në këtë program studimi, plotësojnë kushtet e kërkuara nga Ligji i arsimit të Lartë për nivelin e duhur profesional për natyrën dhe modulet e këtij programi.</i> <i>Për sa i përket kualifikimit të stafit, jo i gjithë personeli akademik, që angazhohet në këtë program studimi plotëson kushtet për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, pasi konstatohet se 30 % e personelit akademik janë me Msc, megjithatë të gjithë janë në proces mbrojtjeje doktorature.</i> <i>Fakulteti i Drejtësisë plotëson kërkesat për ngarkesën mësimore, rekrutimin dhe kontraktimin e stafit akademik në përputhje me kuadrin ligjor, duke ruajtur dokumentacion të rregullt dhe evidencë të plotë përmes Zyrës së Burimeve Njerëzore.</i> <i>Mjediset mësimore janë të përshtatshme dhe përfshijnë laboratorë funksionalë me staf ndihmës të dedikuar. Fakulteti ka zhvilluar marrëveshje bashkëpunimi për praktikën profesionale dhe ndjek me serioz procesin e mbikëqyrjes</i>



	<i>akademike të studentëve në realizimin e diplomës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Programi i Integruar i Ciklit të Dytë të studimeve në “Drejtësi” realizohet në një infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore për studentët dhe stafin akademik. Për të mundësuar këtë program studimi, Fakulteti i Drejtësisë ka në dispozicion: • 11 salla leksioni; • 14 salla seminari; Institucioni disponon gjithashtu një sërë mjedisesh mbështetëse si salla kompjuterash, laboratorë informatike, një sallë biblioteke, sallë konferencash si dhe një sërë mjedisesh për ushtrimin e aktiviteteve shplohëse e rikreative për studentët. <i>Tabela nr.16 - Mjediset e Fakultetit të Drejtësisë;</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi që mjediset mësimore janë të pajisura me mjete të teknologjisë së lartë. Sallat ku zhvillohet mësimi janë të pajisur me PC dhe projektor të lëvizshëm, ndërkohë që laboratorët janë të pajisur me kompjutera, duke ju lehtësuar pedagogëve dhe studentëve procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Në takimin me studentë u evidentua mundësia e përdorimit të sallave të laboratorëve edhe gjatë procesit të realizimit të detyrave të kursit dhe punimit të tezës së diplomës. <i>Tabela nr.16 - Mjediset e Fakultetit të Drejtësisë;</i> <i>Tabela nr.17 – Biblioteka;</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

60

Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Edhe mjediset e tjera i sigurojnë bindshëm kërkesat për një infrastrukturë moderne dhe të nevojshme për punë të mirëfilltë akademike dhe shkencore në realizimin e programit. Pjesë e infrastrukturës së Fakultetit të Drejtësisë është edhe një sallë për të zhvilluar gjyqe imituese me qëllim aftësimin praktik të studentëve, në dispozicion të studentëve të këtij program, e paisur me 18 kompjutera dhe mjetet e përshtatshme për zhvillimin e gjyqeve simuluese ose aktiviteteve të ngjashme të aftësimin praktik. <i>Tabela nr.16 - Mjediset e Fakultetit të Drejtësisë;</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Institucioni disponon me ambient të tillë infrastrukturor. Fakulteti i Drejtësisë disponon kompjutera në Klinikën e Ligjit, Laboratorin e Kriminologjisë dhe Bibliotekë, duke lehtësuar aksesin e studentëve në informacion dhe punën kërkimore. Në të gjithë ambientet e fakultetit ofrohet internet falas, ndërsa platformat online si COBISS.al, JSTOR dhe U-Library mbështesin procesin mësimor, kërkimor dhe profesional të studentëve dhe stafit akademik. <i>Tabela nr.16 - Mjediset e Fakultetit të Drejtësisë;</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e	Infrastruktura fizike e institucionit siguron një mjedis të mjaftueshëm, të përshtatshëm dhe adekuat për realizimin e programit. Programi i integruar i ciklit të dytë në Drejtësi përfiton nga marrëveshjet e bashkëpunimit të Fakultetit të Drejtësisë, UT, që sigurojnë mjedise të përshtatshme për zhvillimin e praktikave profesionale. Bashkëpunimet me institucione dhe subjekte të ndryshme garantojnë realizimin efektiv të veprimtarive praktike për studentët. <i>Evidenca 29.1 Marrëveshje Bilaterale të Nënshkruara nga UT 2020-2024;</i> <i>Evidenca 29. 1</i>

nevojshme.				
Konkluzione	GVJ konstaton se Institucioni disponon padyshim një infrastrukturë moderne sipas secilit standard për realizimin me sukses të programit. Fakulteti i Drejtësisë plotëson kriteret infrastrukturore dhe teknologjike duke ofruar ambiente të përshtatshme mësimore, akses në internet në të gjithë hapësirat, 28 kompjutera të shpërndarë në laboratorë dhe bibliotekë, si dhe shërbime biblioteka online përmes platformave COBISS.al, JSTOR dhe U-Library, që mbështesin procesin mësimor, kërkimor dhe profesional të studentëve dhe stafit akademik.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Në përgjithësi, literatura bazë dhe e rekomanduar është adekuate sipas planprogramit të paraparë. Pjesë e syllabuseve të lëndëve të këtij program studimi është edhe literatura e detyrueshme dhe e këshillueshme. Studentët njihen më literaturën nëpërmjet programit mësimor në fillim të procesit akademik, si dhe gjatë vijësisë së procesit të mësimdhënies nëpërmjet komunikimit me pedagogun përgjegjës. Studentët njihen me literaturën e syllabuseve si në formë elektronike, ashtu edhe në hard copy. Nga shqyrtimi i programeve mësimore të lëndëve/moduleve, konkludohet se elementi i literaturës që i referohet syllabuseve të ndryshme është literaturë bashkëkohore. Burimet e literaturës janë në përshtatje me dijet që synohet ti jepen studentit si dhe qëllimet akademike të programit ndonëse duhet të pasqyrohen më të plota në syllabuset e lëndëve.
	<i>Evidenca Syllabuset e cdo lende 1;</i>



	<i>Evidenca Syllabuset e cdo lende 2;</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Gjatë takimit me stafin akademik, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstatoi se titullarët e lëndëve, në bashkëpunim të ngushtë me departamentet përkatëse, ndërmarrin rishikime të rregullta të programeve mësimore të lëndëve që mbulojnë, me qëllim reflektimin e zhvillimeve të fundit teorike dhe praktike në fushën e së drejtës. Çdo vit akademik, si pjesë e procesit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, programet i nënshtrohen një cikli të strukturuar përmirësimi. Titullarët rishikojnë dhe përditësojnë përmbajtjen e lëndëve, përfshirë objektivat, rezultatet e të nxënës dhe literaturën bazë e të rekomanduar. Propozimet e tyre i paraqiten përgjegjësit të departamentit për shqyrtim dhe miratim. Ky proces synon të garantojë që studentët të kenë akses në burime bashkëkohore, në përputhje me zhvillimet më të fundit në fushën e shkencave juridike. <i>Evidenca 20 Syllabuset</i> <i>Evidenca 42. Të Dhëna mbi Bibliotekën e Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës;</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka si ambient i përshtatshëm për studime është e pasur, është moderne dhe shfrytëzimi i saj është padyshim i barabartë për studiuesit. <i>Vizita në institucion e ambienteve</i> <i>Evidenca 42. Të Dhëna mbi Bibliotekën e Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës;</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të	Në funksion të aktivitetit kërkimor shkencor të stafit akademik dhe studentëve është ngritur dhe funksionon biblioteka, pjesë e infrastrukturës së Fakultetit. Biblioteka disponon me një fond të konsiderueshëm të literaturës. Katalogimi është i saktë dhe i qartë si dhe i përditësuar. Kjo vlen si për mënyrën fizike, poashtu atë online. Biblioteka ka një hapësirë dhe organizim të përshtatshëm që mundëson përdorimin në kushte optimale. Në kuadrin e të drejtave të tyre, studentët kanë të drejtën të përdorin infrastrukturën që fakulteti vë në dispozicion të procesit mësimor si dhe të përfitojnë nga shërbimet mbështetëse që institucioni ofron. Në këtë kuadër, ata kanë të drejtën e përdorimit në mënyrë të barabartë të mjediseve të bibliotekës

studimit.	dhe çdo shërbimi tjetër që ofrohet për realizimin e programit të studimit. <i>Evidenca 42. Të Dhëna mbi Bibliotekën e Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës;</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Biblioteka online është e qasshme për secilin student. Biblioteka e Fakultetit të Drejtësisë plotëson kriteret infrastrukturore dhe teknologjike përmes abonimeve në bibliotekat elektronike JSTOR dhe U-Library, si dhe kapaciteteve të mira infrastrukturore si kompjuterë dhe Ëi-Fi. Për më tepër, si pjesë e rrjetit COBISS.Net, biblioteka ka akses në një sistem të përbashkët bibliografik që mbulon bibliotekat kryesore universitare në Shqipëri dhe rajonin e Evropës Juglindore, duke mundësuar shfletimin dhe qasjen e informacionit bibliografik në mënyrë të thjeshtë dhe të gjerë. Rreth 20% e fondit të bibliotekës është tashmë i regjistruar në katalogun elektronik, duke përmirësuar ndjeshëm aksesin dhe menaxhimin e burimeve të saj. <i>Evidenca 42 Të Dhëna mbi Bibliotekën e Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës;</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka disponon me infrastrukturë të konsoliduar dhe bashkëkohore kompjuterike për të gjithë studentët e këtij programi studimi. <i>Vizita në institucion e ambienteve</i> <i>Evidenca 42. Të Dhëna mbi Bibliotekën e Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës;</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka e institucionit është pastër si dhe moderne. Kapaciteti i saj fizi do të mund të konsiderohet se është së paku me standarde minimale të domosdoshme. Orari i shfrytëzimit të sallës së leximit është prej orës 08.00 deri 16.00. Një orar i tillë mund të konsiderohet si i shkurtër për nevoja bashkëkohore të studentëve të juridikut. Orari i Bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit që fillon: nga e Hënë-Premte 08:00 — 16:00. Ndërsa gjatë sezonit të provimeve është e hapur me orar të zgjatur. <i>Rekomandim: Më së paku, salla e leximit do të duhej të jetë e</i>

	hapur me orar më të zgjatur. Brenda mundësive organizative, kjo sallë do të duhej të ishte e hapur prej të hënës deri të shtunën dhe atë me orar 08.00 deri 20.00 ose së paku 19.00.			
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Biblioteka ka të avancuar sistemin e menaxhimit të këtij aspekti. Bashkëpunimi me njësitë përkatëse përgjegjëse duket të jetë i mirëfilltë për këtë. Biblioteka e Fakultetit të Drejtësisë pasurohet çdo vit me literaturë të re përmes blerjeve dhe dhurimeve nga autorë, institucione dhe doktoratura të mbrojtura në fakultet. Gjatë periudhës 2019-2023 janë shtuar në fond 852 libra, prej të cilëve 330 janë blerje dhe 522 dhurime, duke përmirësuar vazhdimisht burimet për studentët dhe stafin akademik. <i>Evidenca 42 Të Dhëna mbi Bibliotekën e Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës;</i>			
Konkluzione	<i>Biblioteka fizike dhe online vihet në dispozicion të të gjithë studentëve në mënyrë të barabartë, pa pagesë dhe në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor për këtë program studimi.</i> <i>Salla e bibliotekës ka internet dhe është e pajisur me kompjutera që kanë të instaluar programe që u mundësojnë studentëve aksesin në bibliotekën elektronike.</i> <u><i>Nëse merret në konsideratë rekomandimi i dhënë për orarin e sallës së studimit në bibliotekë, institucioni do të mund të krenohet me të arriturat edhe në këtë segment organizativ për realizimin e programit.</i></u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Materiali i paraqitur nga ana e institucionit ofron në pasqyrë të përgjithshme dhe të qartë për studentët përgjatë studimeve sipas programit. Fakulteti i Drejtësisë disponon një sistem elektronik të menaxhimit të të dhënave studentore, i cili mbulon gjithë procesin nga regjistrimi deri në diplomim, duke siguruar administrim efikas dhe të centralizuar të informacionit. Përveç kësaj, studentët e fakultetit janë aktivë në projekte bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar, përfshirë shkolla verore, kompeticione, programe mobiliteti si Erasmus+ dhe seminare të ndryshme, që rrisin eksperiencën e tyre akademike dhe ndërkombëtare. Kjo përfaqëson një aspekt të rëndësishëm të zhvillimit profesional të studentëve gjatë periudhës 2019-2024. <i>Evidenca 29.2 Lista e Mobilitetit të Studentëve në FDUT 2019-2023;</i> <i>Evidenca 29.6 Studentë të Angazhuar në Takime dhe Aktivitete të Realizuara 2019-2024;</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Institucioni mirëmban sistem të brendshëm informativ lidhur me personelin e përfshirë në realizimin e programit.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e	Ekziston mundësia e lehtë e qasjes në informacione e materiale lidhur me personelin dhe studentët e programit. Fakulteti siguron shpërndarje të plotë të çdo informacioni dhe aktiviteti që lidhet me Programin e Studimit, përmes faqes zyrtare online të institucionit, rrugëve elektronike drejt stafit

programit të studimit.	akademik dhe studentëve, si edhe përmes rrjeteve sociale që administron fakulteti. Përveç kësaj, informacioni publikohet edhe nga Zyra e Informacionit.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Institucioni disponon me sistem të tillë për komunikim interaktiv personel akademik – student. GVJ-ja konstaton se platforma “Microsoft Teams” është e organizuar për të ofruar akses të dedikuar për të gjitha kategoritë e përdoruesve të planifikuar në këtë platformë. Përdorimi i platformave online Google Classroom dhe Teams, nga pedagogët e angazhuar në këtë program studimi ofron mundësi më të mëdha për një komunikim interaktiv me studentët, si edhe shkëmbim informacioni, ofrim materiale, si dhe realizim të Quizz-ve, në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Disponohet me sistem efikas në procesin e monitorimit për aktivitetet akademike për personelin dhe studentët. Fakulteti përdor Platformën Microsoft Teams për komunikim interaktiv dhe publikim materialesh për studentët, duke mundësuar monitorimin në kohë reale të aktiviteteve. Përveç kësaj, sistemi elektronik i menaxhimit të informacionit përmes rrugëve elektronike, faqes zyrtare, rrjeteve sociale dhe Zyrës së Informacionit siguron monitorim të vazhdueshëm të aktivitetit akademik dhe administrativ, duke lejuar gjithashtu evidentimin dhe trajtimin në kohë reale të çdo problematike të raportuar. https://fdut.edu.al/
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, ka zhvilluar gjatë viteve akademike të programit "Drejtësi" një sërë takimesh dhe aktiviteteve për të forcuar bashkëpunimin dhe partneritetet me institucione të arsimit të lartë, IAL-të, organizata të shoqërisë civile dhe aktorë të tjerë relevantë në fushën e kërkimit shkencor dhe realizimit të projekteve. Përmbledhja e këtyre aktiviteteve është e publikuar në faqet zyrtare të Fakultetit. https://unitir.edu.al/category/evente/https://fdut.edu.al/
Konkluzione	<i>Institucioni disponon sistem për monitorimin e mbarëvajtjes së punës akademike të personelit dhe studentëve.</i> <i>Fakulteti i Drejtësisë ka ndërtuar partneritete të forta akademike dhe bashkëpunime të frytshme me institucione të</i>

	ndryshme. Komunikimi me studentët dhe stafin realizohet në mënyrë efektive përmes platformave digjitale dhe rrjeteve sociale, duke siguruar akses dhe monitorim në kohë reale. Organizimi dhe publikimi i eventeve dhe aktiviteteve garanton transparencë dhe informim të mirëfilltë. Këto elemente përforcojnë cilësinë dhe efikasitetin e procesit arsimor dhe kërkimor në fakultet.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Institucioni mirëmban raporte kredibile financiare për mbarëvajtjen e programit. Bordi i Administrimit të Universitetit të Tiranës miraton çdo vit buxhetin për Fakultetin e Drejtësisë duke u bazuar në nevojat reale dhe analizën e realizimit të vitit të mëparshëm. Ky buxhet përfshin kuotat për investime, pagat e stafit, shpenzimet operative dhe mirëmbajtjen infrastrukturore, duke siguruar mbështetje të qëndrueshme për funksionimin dhe zhvillimin e Fakultetit. <i>Evidenca 39 Vendim i Bordit të Administrimit, Universiteti i Tiranës "Mbi miratimin e Buxhetit të vitit 2024 të UT-së;"</i> <i>Evidenca 39.1 Realizimet dhe Propozimet për Buxhetin e Viteve 2019-2023_compressed;</i>



Kriteri 2.Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologji mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Institucioni harton dhe mirëmban plane kredibile financiare për të gjitha strukturat organizative. Buxheti përfshin kuotat e detajuara për vitin kalendarik, investime të brendshme për pajisje elektronike dhe mobilim auditorësh, përmirësime softuerësh dhe bazash të dhënash. Gjithashtu, përfshihen fondet për pagat e stafit, shpenzimet operative dhe infrastrukture, si dhe abonimet në biblioteka elektronike dhe publikime shkencore. Ky proces mbështetet në analizën e realizimeve dhe propozimeve për periudhën 2019-2023.
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Institucioni realizon rregullisht auditim intern të vazhdueshëm financiar. Fakulteti i Drejtësisë i nënshtrohet auditimit të brendshëm periodik nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të Universitetit të Tiranës, i cili përfshin auditimin e përputhshmërisë dhe auditimin financiar. Ky auditim kryhet sipas standardeve të auditimit të brendshëm të miratuara në Shqipëri. Ai vlerëson menaxhimin financiar, sistemin e pagave, burimet njerëzore, menaxhimin buxhetor, procedurat e prokurimit publik, kontabilitetin dhe raportimin financiar, si dhe zbatimin e normave dhe tarifave të shkollimit. Raportet e auditimit sigurojnë saktësinë e regjistrave financiarë dhe respektimin e legjislacionit në fuqi. <i>Evidenca 39.2 Raportet e Auditimit të Brendshëm 2015-2017 dhe 2021-2022;</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi	Raportet e institucionit për pasqyrat financiare për secilën njësi bazë janë të qarta dhe kredibile.



realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Tabela 18			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Institucioni si autoritet publik menaxhon resurset organizative në funksion të qëndrueshmërisë financiare për mbarëvajtjen e programit. Menaxhimi nënkupton edhe evaluimin e menaxhimit financiar në rast të përmirësimit të situatës. <i>Evidenca 13. Vendime të Senatit Akademik të UT-së si psh "Për Miratimin Paraprak të Tarifës së Regjistrimit dhe Shkollimit për Programin e Studimit "Master i Shkencave në Drejtësi" për Vitet akademike 2019-2023;</i>			
Konkluzione	<i>Institucion garanton qëndrueshmërinë financiare lidhur me programin.</i> <i>Fakulteti i Drejtësisë i nënshtrohet auditimit të brendshëm periodik nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të Universitetit të Tiranës.</i> <i>UT si institucion buxhetor, i financuar kryesisht nga të ardhurat publike, garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

70

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës ka implementuar procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve. Procesi i pranimin të studentëve është transparent, duke garantuar akses të barabartë dhe mbështetje për kategoritë me nevoja të veçanta. Studentët e rinj orientohen për strukturën akademike, metodat e vlerësimit dhe përdorimin e burimeve institucionale. Politikat janë në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të arsimit të lartë dhe rishikohen periodikisht. Në përgjithësi, sistemi i politikave është i plotë, transparent dhe mbështetës, duke siguruar një mjedis akademik të suksesshëm dhe përputhshmërinë me kërkesat ligjore. Kriteret janë të parashikuara edhe në aktet rregullatore të UT, si statuti, rregullore e UT-së, rregullore programi etj. <i>Evidenca 2. Statuti i UT-së;</i> <i>Evidenca 3. Rregullorja e UT-së;</i> <i>Evidenca 15. Rregullorja e Programit të Studimi të Integruar të Ciklit të Dytë në Drejtësi;</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstaton se Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës ka zhvilluar dhe zbatuar politika dhe procedura të drejta, që garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët dhe studentët. Kjo përfshin mundësinë e realizimit të praktikave profesionale në institucione të ndryshme dhe mbështetje për zhvillimin e karrierës nga Dega e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni. Politikat janë në përputhje me legjislacionin dhe ofrojnë mundësi të barabarta për zhvillim profesional dhe përparim akademik për të gjithë studentët. <i>Evidenca Nr. 28 Raport për Alumni-Dega e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni FDUT;</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e	GVJ konstaton se Universiteti i Tiranës ka hartuar dhe publikuar kriteret e pranimin përpara çdo viti akademik në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kriteret përfshijnë përfundimin me sukses të maturës shtetërore dhe



kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	një notë mesatare, si dhe njohuri të gjuhës angleze për disa programe. Informacioni mbi kriteret e pranimi është i qartë dhe i aksesueshëm për kandidatët përmes faqes zyrtare të universitetit dhe shpërndarjes në njësi përkatëse. Kjo siguron transparencë dhe qartësi për të gjithë kandidatët dhe garanton se procesi i pranimi është në përputhje me legjislacionin dhe rregullat e përcaktuara. <i>Evidenca 2. Statuti i UT-së;</i> <i>Evidenca 3. Rregullorja e UT-së;</i> <i>Evidenca 25.2 Kalendar i Për Procedurat e Aplikimit dhe Regjistrimit 2024 – 2025;</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Referuar RVB-së, GVJ konstaton se Fakulteti i Drejtësisë ka krijuar një sistem të qartë dhe të aksesueshëm për pranimin, përzgjedhjen e studentëve, si dhe për transferimin dhe njohjen e krediteve akademike, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore. Procedurat janë të qarta dhe transparente, duke përfshirë vlerësimin e dijeve dhe diplomimit. Nga intervistat me studentët ata kanë akses në informacion dhe dokumente përmes faqes zyrtare të fakultetit, duke siguruar transparencë dhe mundësi për njohuri të vazhdueshme. Për sa i përket transferimeve dhe njohjes së studimeve të mëparshme, Statuti i Universitetit të Tiranës, në nenet 109 dhe 112, parashikon procedura të detajuara për transferimin e studentëve dhe ekuivalentimin e diplomave të marra nga institucione të tjera, si dhe për njohjen e periudhave të studimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi, siç është Ligji Nr. 80/2015. Për këto procedura është ngritur një komision i posaçëm, i cili shqyrton kërkesat për transferim dhe ekuivalentim të diplomave, duke siguruar një proces të qartë dhe të drejtë për studentët. <i>Evidenca 2. Statuti i UT-së;</i> <i>Evidenca 25.2 Kalendar i Për Procedurat e Aplikimit dhe Regjistrimit 2024 – 2025;</i> <i>Evidenca 25.1. Vendim Dekanati Për Kriteret e Pranimi në FDUT;</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon	GVJ konstaton se Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës zbaton në mënyrë të rregullt dhe transparente detyrimin për informimin e publikut dhe palëve të interesuara




publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	mbi kërkesat dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në programet e studimit, përpara fillimit të çdo viti akademik. Ky informacion bëhet publik në një kohë të përcaktuar dhe në përputhje me kërkesat ligjore. Në mënyrë të veçantë, për programin e integruar të ciklit të dytë në drejtësi, kriteret dhe kërkesat janë të parashikuara në Rregulloren përkatëse të programit. <i>Evidenca Nr. 2 Statuti i UT-së, neni 125</i> <i>Evidenca Nr.3 Rregullorja e UT-së</i> <i>Evidenca nr.15 Rregullorja e programit të studimit të integruar të ciklit të dytë në Drejtësi;</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	GVJ konstaton se Fakulteti i Drejtësisë ka kriteret dhe procedura të qarta për pranimin e kandidatëve me aftësi të veçanta dhe grupeve të pakicave, duke siguruar trajtim të barabartë dhe mundësi për të aplikuar. Këto kriteret publikohen para fillimit të vitit akademik dhe respektojnë rregulloren e UT-së. <i>Evidenca Nr.25 Vendime për miratimin e kuotave për këto kategori;</i> <i>Evidenca Nr.3 Rregullorja e UT-së</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Fakulteti i Drejtësisë ka kriteret të qarta dhe të drejta për pranimin e kandidatëve ndërkombëtarë, duke publikuar kriteret përpara fillimit të vitit akademik. Institucioni bashkëpunon me ambasadat dhe organizatat ndërkombëtare për mbështetje dhe informacion për studentët që aplikojnë nga jashtë. <i>Evidenca Nr. 25.3 Shembull vendim komisioni ad hoc për transferimin e studentëve;</i> <i>Evidenca Nr. 3 Rregullorja e UT-së, neni 39;</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtesa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Fakulteti i Drejtësisë ofron mundësi mbështetjeje për studentët në nevojë, duke ofruar bursat dhe ndihmën financiare për ata që kanë nevojë, dhe duke siguruar mundësi për vazhdimin e studimeve. Politikat mbështetëse janë të qarta dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe institucionale. <i>Evidenca Nr. 2 Statuti i UT-së, neni 125</i>

Konkluzione	<i>GVJ konstanton se:</i> <i>Politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tjera rregullatore.</i> <i>Institucioni publikon përpara fillimit të çdo viti akademik, kriteret dhe procedurat e pranimit në programin e studimit duke garantuar akses në informacion dhe barazi në procesin e pranimit të aplikimeve dhe të përzgjedhjes për të gjithë kandidatët.</i> <i>Fakulteti i Drejtësisë ka përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara për pranimin, vlerësimin dhe mbështetje për studentët, duke siguruar transparencë, drejtësi dhe mundësi të barabarta për të gjithë kandidatët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ konstaton se Fakulteti i Drejtësisë garanton transparencë të informacionit në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve. Përmes rregullores së programit të studimit, janë përcaktuar qartë kushtet për kalimin nga një vit akademik në tjetrin, duke u bazuar në performancën akademike të studentëve. Këto kriteret janë të dokumentuara dhe të publikuara, duke mundësuar informimin e plotë të studentëve mbi ecurinë e tyre akademike. <i>Evidenca nr.15 Rregullorja e programit të studimit të integruar të ciklit të dytë në Drejtësi;</i> <i>Evidenca nr.3 Rregullorja e UT-së;</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e	Fakulteti i Drejtësisë garanton informim të qartë dhe të strukturuar për studentët në lidhje me procedurat dhe kriteret e njohjes së kualifikimeve të mëparshme dhe transferimit të

njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	studimeve. Në përputhje me Statutin e UT-së dhe legjislacionin në fuqi, janë të përcaktuara kompetencat e strukturave përgjegjëse për shqyrtimin e kërkesave dhe miratimin e transferimeve, si dhe procedurat për njohjen e krediteve. Studentët kanë akses në këtë informacion dhe proceset janë transparente dhe të dokumentuara. <i>Evidenca Nr. 2 Statuti i UT-së;</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Fakulteti i Drejtësisë ofron informacion të plotë dhe të qartë lidhur me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të studentëve. Në orën e parë të fillimit të procesit mësimor për secilën lëndë, studentëve ju ofrohet informacion nga pedagogu për syllabusin e lëndës, detyrimeve për tu përmbushur si edhe mënyrën e vlerësimit. Ky informacion u komunikohet studentëve në kohë. Procedurat janë transparente dhe të aksesueshme, si dhe studentëve u mundësohet të kërkojnë rishikim të rezultateve apo të përmirësojnë performancën e tyre akademike. <i>Evidenca nr.15 Rregullorja e programit të studimit të integruar të ciklit të dytë në Drejtësi</i> <i>Evidenca nr.3 Rregullorja e UT-së</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Fakulteti i Drejtësisë ofron informacion të detajuar dhe të qartë për studentët lidhur me kriteret për përzgjedhjen dhe zhvillimin e temës së diplomës, afatet përkatëse, si dhe procedurat për dorëzimin dhe mbrojtjen e saj. Këto informacione janë të dokumentuara në udhëzime specifike dhe në aktet rregullatore të Universitetit të Tiranës duke garantuar transparencë dhe akses të barabartë për të gjithë studentët. Referuar <i>kreut V</i> të rregullores së programit të studimit janë të përcaktuara të gjitha hapat e diplomimit. Në përfundim të programit integruar të studimeve të ciklit të dytë në drejtësi, studenti që diplomohet duke mbrojtur një punim diplome duhet ta përgatisë punimin sipas specifikave të përcaktuara nga departamenti. Drejtuesit e temave të diplomës miratohen nga departamenti. Për udhëheqjen e diplomave të studentëve në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë kërkohet që pedagogu udhëheqës të ketë minimalisht gradë shkencore. Departamenti brenda një muaji nga dita e fillimit të semestrit të parë të vitit të fundit, u bën të njohur



	studentëve të vitit të fundit temat e diplomave. <i>Evidenca nr.2 Statuti i UT-së;</i> <i>Evidenca nr.3 Rregullorja e UT-së;</i> <i>Evidenca nr.15 Rregullorja e programit të studimit të integruar të ciklit të dytë në Drejtësi;</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Nga shqyrtimi i evidencave konstatohet se Fakulteti i Drejtësisë zbaton një sistem të strukturuar dhe funksional të informimit për studentët aktualë dhe të ardhshëm, përmes publikimit të manualeve dhe udhëzuesve përkatës, si dhe organizimit të aktiviteteve dhe takimeve informuese. Këto veprimtari garantojnë transparencë dhe qasje të gjerë në informacionin mbi programet e studimit, kërkesat akademike dhe mbështetjen institucionale. Informacioni është gjithashtu i aksesueshëm në faqen zyrtare të institucionit dhe në platformat përkatëse. <i>Evidenca nr. 34.2 Manual për studentët e FDUT-së</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se institucioni ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura të qarta që mbulojnë të gjithë ciklin akademik të studentëve, përfshirë pranimin, transferimin e krediteve, procesin e mësimdhënies dhe diplomimin.</i> <i>Këto politika janë transparente, të aksesueshme publikisht dhe garantojnë trajtim të barabartë për të gjithë studentët.</i> <i>Institucioni ofron gjithashtu mbështetje ekonomike për shtresat në nevojë dhe bursa për studentët me rezultate të larta, duke nxitur përfshirjen dhe ekselencën akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët	Studentët e programit marrin informacion të detajuar për

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.asc.al

76

informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	komponentët akademikë përmes pedagogëve, Sekretarisë Mësimore, akteve rregullatore dhe dokumenteve zyrtare të publikuara nga institucioni. Në fillim të vitit akademik, pedagogët prezantojnë përmbajtjen dhe detyrimet përkatëse për çdo lëndë. Informacioni gjendet gjithashtu në Kurrikulën dhe Guidën e Studentit, e cila përfshin aspekte akademike, administrative dhe infrastrukturore të programit. Këto informacione gjenden edhe në faqen zyrtare të internetit të Fakultetit të Drejtësisë ee.fdut.edu.al <i>Evidenca nr. 2 Statuti i UT-së;</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Studentët e këtij program studimi marrin informacion më të detajuar për të gjithë elementët lidhur me modulet e kurrikulës së programit, gjatë prezantimit të orës së parë të mësimit nga pedagogët e lëndës. Informacion të detajuar studentët mund të gjejnë edhe në: sekretarinë mësimore, faqen eeb të FD, afishimeve në ambjentet e Fakultetit, rrjeteve sociale. Fakulteti i Drejtësisë ofron informacion të plotë për çdo lëndë/modul, në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UT-së. Studentët informohen mbi përmbajtjen, objektivat, metodat e mësimdhënies dhe rezultatet e pritura përmes syllabus-eve. Gjithashtu, dokumentacioni për aktivitete formuese si praktikrat dhe projektet është i disponueshëm dhe i aksesueshëm. <i>Evidenca nr. 2 Statuti eiUT-së ;</i> <i>Evidenca nr. 3 Rregullore e UT-së ;</i> <i>Evidenca nr. 20 "Model syllabusi;</i> <i>Evidenca nr. 32 Dokumentacioni mbi praktikrat mësimore 2024-2025;</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Fakulteti i Drejtësisë ofron informacion mbi mundësitë e punësimit dhe bashkëpunimet me punëdhënësit për studentët e diplomuar. Institucioni siguron mbështetje për orientimin profesional përmes shërbimeve të këshillimit të karrierës, si dhe ofron mundësi për internship dhe punë pas diplomimit. <i>Evidenca nr. 28.1 "Studim Tregu 2022 për studentët që diplomohen në UT;</i> <i>Evidenca nr. 28 Raport për Alumni-Dega e Këshillimit te Karrieres</i>



	<i>clhe Alumni FDUT;</i>			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ konstatoi se Sekretaria Mësimore, si dhe pedagogët e Departamenteve të Fakultetit luajnë një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi, që në fazën e regjistrimit të studentëve e më pas me fillimin e vitit akademik. <i>Evidenca nr. 2 Statuti i UT-së</i> <i>Evidenca nr. 3 Rregullorja e UT-së</i> <i>Evidenca nr.20.3 Manual përdorimi – Sistemi e-studentët</i> <i>Evidenca nr. 32.1 Raport Klinika e Ligjit</i> <i>Evidenca nr.35 Zyra e mbështetjes psikologjike në FDUT</i> <i>Evidenca nr. 42 Të dhëna mbi bibliotekën e FDUT-së</i>			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	GVJ evidenton se Fakulteti i Drejtësisë garanton akses të lehtë dhe në distancë lidhur me informacionin mbi programin e studimit përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit. Studentëve u vihet në dispozicion: Platforma online “e-studentët”, e cila siguron informacion të detajuar mbi programin e studimit, lëndët dhe rezultatet akademike. Akses në distancë nëpërmjet faqes zyrtare të fakultetit dhe portalit të studentëve, që ofrojnë informacione akademike dhe administrative (ëëë.fdut.edu.al). <i>Evidenca nr. 20.3: Manual përdorimi – Sistemi e-studentë;</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se studentët e programit marrin informacion të detajuar mbi komponentët akademikë përmes pedagogëve, Sekretarisë Mësimore, akteve rregullatore dhe vendimeve zyrtare të publikuara nga institucioni. Në fillim të vitit akademik, pedagogët prezantojnë përmbajtjen dhe detyrimet përkatëse për çdo lëndë. Ky informacion është i përfshirë edhe në Kurrikulën dhe Guidën e Studentit, të cilat përmbajnë aspektet akademike, administrative dhe infrastrukturore të programit. Këto të dhëna janë në dispozicion edhe në faqen zyrtare të Fakultetit të Drejtësisë, ëëë.fdut.edu.al.			
Shkalla e përmbushjes së	Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet


standardit	përmbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve												
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	GVJ konstaton nga shqyrtimi i dokumentacionit gjatë vizitës se Fakulteti i Drejtësisë nëpërmjet strukturave të tij, disponon dhe administron statistika vjetore mbi numrin e studentëve të diplomuar. Në përputhje me normat ligjore në fuqi si dhe ato të akteve rregulatore të institucionit, Sekretaria Mësimore administron një regjistër të veçantë, dhe disponon një sistem të mirëorganizuar për mbledhjen dhe administrimin e statistikave vjetore mbi numrin e studentëve dhe të diplomuarve në programin e studimit. Të dhënat janë të sakta, të përditësuara dhe pasqyrohen në raportet vjetore të institucionit. <i>Evidenca nr. 27 Raporte vjetore 2019–2023</i>												
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Në ushtrim të funksioneve të saj, Sekretaria Mësimore administron dokumentacionin që përmban të dhënat e studentëve të regjistruar në këtë program studimi. Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit dhe vizitën në institucion, evidentohet se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi është si më poshtë: <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th><th>Numri i të regjistruarve</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Viti 2019-2020</td><td>651 studentë</td></tr> <tr> <td>Viti 2020-2021</td><td>645 studentë</td></tr> <tr> <td>Viti 2021-2022</td><td>660 studentë</td></tr> <tr> <td>Viti 2022-2023</td><td>673 studentë</td></tr> <tr> <td>Viti 2023-2024</td><td>673 studentë</td></tr> </tbody> </table>	Viti akademik	Numri i të regjistruarve	Viti 2019-2020	651 studentë	Viti 2020-2021	645 studentë	Viti 2021-2022	660 studentë	Viti 2022-2023	673 studentë	Viti 2023-2024	673 studentë
Viti akademik	Numri i të regjistruarve												
Viti 2019-2020	651 studentë												
Viti 2020-2021	645 studentë												
Viti 2021-2022	660 studentë												
Viti 2022-2023	673 studentë												
Viti 2023-2024	673 studentë												
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të	FD ka një sistem të brendshëm menaxhimi të informacionit që siguron ruajtjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave të studentëve në përputhje të plotë me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe rregulloret e Universitetit për												

brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	përpunimin e të dhënave. Të dhënat ruhen në mënyrë të sigurt dhe janë të aksesueshme vetëm për personelin e autorizuar. Ky sistem garanton organizimin dhe strukturimin e informacionit në mënyrë që administrata dhe autoritetet përkatëse të kenë mundësi të kryejnë verifikime të thjeshta dhe të sigurt, duke respektuar gjithmonë parimet e konfidencialitetit dhe integritetit të të dhënave personale. <i>Evidenca nr. 40 Rregullorja për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UT</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Fakulteti i Drejtësisë ka vendosur mekanizma të qartë dhe funksionalë për kontrollin dhe vlerësimin periodik të të dhënave që lidhen me studentët. Njësitë përgjegjëse për menaxhimin e informacionit (si sekretaritë mësimore dhe strukturat e tjera përkatëse) realizojnë kontrole të rregullta për të siguruar që të dhënat dhe dokumentet në lidhje me studentët janë të sakta, të plota dhe të përditësuara. Njësitë administrative dhe sekretaritë mësimore ofrojnë mbështetjen e nevojshme për studentët, duke siguruar që informacioni që u vihet në dispozicion të jetë në përputhje me kërkesat e institucionit dhe me aktet rregullatore përkatëse. <i>Evidenca nr. 15 Rregullorja e programit të studimit të integruar të ciklit të dytë në Drejtësi</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Fakulteti i Drejtësisë harton në mënyrë të rregullt raporte analitike që pasqyrojnë të dhënat e administruara nga Sekretaria Mësimore mbi studentët që regjistrohen në programin e studimit. Fakulteti mbledh dhe analizon të dhëna mbi punësimin e studentëve pas diplomimit nëpërmjet Degës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumni. Raportet mbi alumni ndihmojnë në identifikimin e treguesve të suksesit dhe të fushave që kërkojnë përmirësim në përgatitjen profesionale të studentëve. Gjithashtu, Fakulteti mban evidenca për pjesëmarrjen e studentëve në programe mobiliteti, duke ndjekur ndikimin e tyre në rritjen e kompetencave akademike dhe profesionale të studentëve. <i>Evidenca nr. 28 Raporti për Alumni, Dega e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni FDUT</i>



	<i>Evidenca nr. 29.2 Lista e mobilitetit të studentëve në FDUT 2019–2023</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se Fakulteti i Drejtësisë ka një sistem të mirë-organizuar dhe funksional për mbledhjen, menaxhimin dhe analizimin e të dhënave statistike për studentët dhe performancën e tyre akademike.</i> <i>Sistemet e brendshme të informacionit janë të sigurta, të verifikueshme dhe të aksesueshme për personat e autorizuar, ndërsa mekanizmat e kontrollit periodik dhe vlerësimit të saktësisë së të dhënave sigurojnë besueshmëri dhe cilësi të informacionit.</i> <i>Raportet analitike mbi profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe dalje, si dhe mbi treguesit e punësimit, janë të rregullta dhe përbëjnë një bazë të mirë për vendimmarrje dhe përmirësime të mëtejshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese, në përputhje me aktet ligjore dhe rregullatore në fuqi. Statuti i Universitetit të Tiranës garanton të drejtën e studentëve për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse të institucionit. Këto të drejta zbatohen përmes përfaqësimit të tyre në organet drejtues dhe komisionet e përhershme, në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet e brendshme. Studentët kanë të drejtën të organizohen në Këshillin Studentor dhe në shoqata të tjera studentore të njohura nga institucioni. Këshilli Studentor është një strukturë përfaqësuese dhe këshillimore që shpreh mendimin e


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

81

	studentëve dhe paraqet propozime për çështje që lidhen me jetën akademike, organizimin e studimeve dhe mirëqenien studentore. Ky këshill përfaqësohet në organet kryesore të universitetit, përfshirë Senatin Akademik, Këshillin e Etikës dhe komisionet institucionale. Gjatë vizitës në institucion u konstatua se një studente e programit të integruar të ciklit të dytë në drejtësi ishte anëtare e Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës, çka përforcon faktin se përfaqësimi studentor është aktiv dhe funksional në organet vendimmarrëse edhe në nivel të lartë institucional. Gjithashtu, pranë Universitetit të Tiranës funksionon Komisioni i Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët, i cili shërben si një urë lidhëse mes studentëve dhe administratës për adresimin e nevojave dhe shqetësimeve të tyre. <i>Evidenca nr.2 Statuti i UT-së</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Institucioni garanton që përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësim mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate të verifikueshme e të matshme. Fakulteti i Drejtësisë siguron një përfshirje autentike dhe efektive të studentëve në proceset vendimmarrëse dhe vlerësuese që lidhen me jetën akademike. Pjesëmarrja e studentëve në organet kolegjinale u mundëson atyre të shprehin qëndrime dhe të ndikojnë në vendime që lidhen me programet e studimit, cilësinë e mësimdhënies dhe funksionimin institucional. Përtej përfaqësimit formal, studentët japin kontribut konkret përmes pjesëmarrjes në pyetësorë sistematikë të cilët synojnë të masin kënaqësinë dhe vlerësimet e tyre lidhur me cilësinë e mësimdhënies, infrastrukturën, komunikimin institucional dhe aspektet administrative të procesit mësimor. Të dhënat nga anketimet e studentëve analizohen dhe dokumentohen në raporte përkatëse, të cilat shërbejnë si bazë për ndërmarrjen e masave për përmirësim. Sugjerimet dhe vërejtjet e studentëve janë të pasqyruara në raportet analitike dhe ndikojnë në përditësimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. <i>Evidencës nr. 33.8 "Rezultatet e anketimit të studentëve"</i> <i>Evidencës nr. 33.7 "Njoftime në faqen ëeb për realizimin e"</i>



	<i>pyetësorëve drejtuar studentëve" (ëëë.fdut.edu.al)</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës garanton përfshirjen e studentëve në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit, në përputhje me Statutin e UT dhe aktet e brendshme rregullative. Kjo përfshirje realizohet përmes një sërë mekanizmash të strukturuar si pyetësorë për cilësinë e mësimdhënies, mbledhje të përbashkëta me studentët në kuadër të Departamenteve, si dhe përmes grupeve fokusimi. Statuti i UT njihet të drejtën e studentëve për të kontribuar në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe performancës së stafit akademik. Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në bashkëpunim me strukturat e fakultetit, organizon në fund të çdo semestri pyetësorët e studentëve për të mbledhur opinione mbi përmbajtjen e lëndëve, metodologjinë e mësimdhënies dhe aspektet organizative e administrative të procesit akademik. Të dhënat e mbledhura përpunohen dhe analizohen në mënyrë të sistematizuar dhe iu paraqiten organeve vendimmarrëse të fakultetit. Vërejtjet dhe sugjerimet e studentëve merren parasysh në rishikimin dhe përditësimin e programeve të studimit, duke ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së ofertës akademike. <i>Evidenca nr.2 Statuti i UT-së</i> <i>Evidenca nr. 33.9.1 "Pyetësor mbi zhvillimin e mësimin online-MASR</i> <i>Evidencës nr. 33.8 "Rezultatet e anketimit të studentëve"</i> <i>Evidencës nr. 33.7 "Njoftime në faqen ëeb për realizimin e pyetësorëve drejtuar studentëve" (ëëë.fdut.edu.al)</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/	Rregullorja e programit njihet dhe garanton të drejtën e studentëve për të shprehur mendimin mbi ndershmërinë dhe barazinë e procesit të vlerësimit, përfshirë edhe të drejtën e ankimimit. Procedurat e ankimimit janë të përcaktuara qartë, me afate dhe organe përgjegjëse. Gjatë takimit me GVJ, u konstatua se studentët e kanë ushtruar këtë të drejtë, veçanërisht për rezultatet e provimeve. <i>Evidenca nr. 15 Rregullorja e programit të studimit të integruar të</i>

njesisë/pedagogut përgjegjës.	ciklit të dytë në Drejtësi			
Konkluzione	<i>Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës siguron përfshirjen aktive të studentëve në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, si dhe në proceset e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së shërbimeve.</i> <i>Kjo përfshirje është e dokumentuar dhe realizohet përmes përfaqësuesve në Senatin Akademik, pyetësorëve periodikë dhe takimeve me studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës garanton ofrimin e shërbimeve të informimit dhe mbështetjes ndaj studentëve përmes strukturave të dedikuara dhe procedurave të përcaktuara në aktet rregullatore. Struktura si Sekretaria Mësimore dhe Departamentet përkatëse janë përgjegjës për administrimin e procesit akademik dhe për ofrimin e këshillimit akademik e administrativ. Gjithashtu, Zyra e Karrierës dhe Alumni mbështet studentët në orientimin drejt tregut të punës. Procedurat për trajtimin e ankimeve janë të përcaktuara qartë dhe garantojnë transparencë dhe efikasitet në zgjidhjen e tyre, sipas rregulloreve përkatëse dhe të legjislacionit në fuqi. <i>Evidenca 15. Rregullorja e Programit të Studimi të Integruar të Ciklit të Dytë në Drejtësi;</i> <i>Evidenca 2. Statuti i UT-së;</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të	Fakulteti i Drejtësisë ka krijuar një sistem funksional për informimin, këshillimin dhe ndjekjen e përparimit të studentëve gjatë procesit mësimor. Ky sistem ofron

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.asc.al

84

posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	mbështetje të vazhdueshme për studentët në të gjitha fazat e programit të studimit, përmes këshillimit akademik, orientimit dhe asistencës nga njësitë përkatëse dhe stafi administrativ. Studentët përfitojnë informacion të plotë edhe përmes faqes zyrtare ëeb, si dhe nga udhëzuesi i studentëve. <i>Evidenca nr. 34.2 Guida për studentët e FDUT</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Fakulteti i Drejtësisë ofron mbështetje të vazhdueshme për studentët përmes një njësie të dedikuar për këshillimin e karrierës. Zyra e karrierës mirëpret studentët në mënyrë periodike dhe ofron informacion të specializuar dhe orientim për përfundimin e studimeve, praktikën profesionale në institucione të ndryshme dhe mundësitë e integritit në tregun e punës. Gjithashtu, ndihmon studentët të gjejnë mundësi për internship dhe punësim pas diplomimit. Kjo Zyrë mban gjithashtu lidhjet me studentët edhe pas diplomimit. <i>Evidenca nr. 28 "Raport për Alumni-Dega e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Fakulteti i Drejtësisë ka krijuar një mekanizëm për ndjekjen dhe monitorimin e punësimit të studentëve pas diplomimit. Zyra e karrierës mbledh dhe përpunon të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të të diplomuarve, duke ofruar analiza dhe informacion të aksesueshëm për studentët, autoritetet drejtuese dhe palët e tjera të interesuara. Këto të dhëna përdoren për të identifikuar mundësi për përmirësimin e strategjive të integritit në tregun e punës. <i>Evidenca nr. 28 "Raport për Alumni-Dega e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni</i>
Konkluzione	<i>GVJ evidenton se Fakulteti ka struktura dhe procedura të qarta për informimin dhe mbështetjen e studentëve, të aksesueshme dhe të përshtatshme për nevojat e tyre. Sistemi i këshillimit akademik dhe administrativ siguron asistencë të vazhdueshme gjatë gjithë procesit mësimor, duke kontribuar në përparimin dhe mirëqenien e studentëve.</i>

	<i>Zyra e karrierës ofron mbështetje aktive dhe të specializuar për orientimin profesional dhe ndihmon studentët në integrimin në tregun e punës dhe në gjetjen e praktikave profesionale. Ka një mekanizëm të qëndrueshëm për ndjekjen dhe analizimin e punësimit të studentëve pas diplomimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Institucioni ka prodhuar dokumenta të nevojshme, si udhëzues për sigurinë e cilësisë interne. Fakulteti i Drejtësisë ka hartuar dhe zbatuar udhëzues metodologjik për përdorimin e metodave inovative e të përshtatshme mësimore, duke promovuar mësimin aktiv, përdorimin e teknologjisë dhe qasje ndërdisiplinore. Këto iniciativa mbështeten nga Strategjia e Zhvillimit të UT 2023–2028 dhe përputhen me Ligjin nr. 80/2015 dhe Statutin e UT-së, që përcaktojnë përgjegjësitë e dekanatit dhe strukturave të brendshme për planifikimin dhe zbatimin e strategjive për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. <i>Evidenca 2. Statuti i UT-së;</i> <i>Evidenca 5.1. Strategjia e Zhvillimit të UT-së 2023-2028;</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë	Në bazë të procesit të evaluimit të punës akademike të personelit akademik dhe ndihmës akademik sigurohet monitorimi efikas nga ana e strukturave drejtuese të institucionit.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

86

periodike aftësitë mësimit dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Strukturat përgjegjëse kanë krijuar mekanizma të qëndrueshëm për monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të performancës së stafit akademik dhe ndihmësakademik, në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Tiranës. Këto mekanizma përfshijnë vlerësime periodike të procesit mësues, të cilat ndihmojnë në identifikimin e nevojave për zhvillim profesional dhe rritjen e cilësisë së mësimit. Evidencat tregojnë për ekzistencën e një rregulloreje të posaçme që rregullon vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmësakademik dhe administrativ çka përbën një praktikë të mirë në drejtim të sigurimit të cilësisë. Strukturat përgjegjëse promovojnë gjithashtu angazhimin e pedagogëve në përdorimin e metodologjive të reja dhe inovative, duke nxitur përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimit dhe përshtatjen e saj me kërkesat bashkëkohore të arsimit të lartë. <i>Evidenca nr. 33.5 Rregullore mbi Vlerësimin e Performancës në Punë të Personelit Ndihmës Akademik dhe Administrative në UT;</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimit, të vlerësimit të dijes, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Nëpërmjet evaluimit periodik sigurohet përfshirja e studentëve në vlerësimin e punës akademike të personelit akademik. Fakulteti i Drejtësisë siguron mundësi të hapura për studentët për të dhënë feedback mbi metodat e mësimit dhe procesin e vlerësimit të dijes, duke nxitur përfshirjen aktive të tyre nëpërmjet pyetësorëve të vlerësimit. Gjithashtu, ekzistojnë mekanizma të qartë për ankimim të rezultateve të vlerësimit, që garanton transparencë dhe mundësi rishikimi sipas rregullave të Universitetit të Tiranës. Kjo kontribuon në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së procesit mësues dhe vlerësues. <i>Evidenca 3. Rregullorja e UT-së;</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimit bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Rezultatet e vlerësimit mund të jenë të qasshme për publikun. Fakulteti i Drejtësisë garanton publikimin dhe aksesueshmërinë e rezultateve të vlerësimeve për studentët dhe autoritetet përkatëse, duke promovuar transparencë dhe përmirësim të vazhdueshëm. Ky proces zhvillohet në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 dhe mbështetet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e ngritur dhe funksionale sipas rregulloreve të Universitetit të

	Tiranës.			
	<i>Evidenca 33. Urdhër për Ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</i> <i>Evidenca 33.1 Rregullore UT "Për Organizimin dhe funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Kurrikulës";</i>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Procesi i evaluimit të punës akademike të personelit nga ana e studentëve ndihmon në avancimin e mësimdhënies në program. GJVJ konstatoi angazhimin e institucionit për nxitjen dhe promovimin e pedagogëve përmes pjesëmarrjes në trajnime dhe projekte të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit. <i>Evidenca 33.4 Raportet Vjetore të Monitorimit të KSBCNJSBC;</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ka siguruar një proces të mirëfilltë monitorimi për punën akademike të personelit nëpërmjet metodës së vlerësimit periodik nga ana e studentëve</i> <i>Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve në fund të çdo semestri, si dhe analizat vjetore të realizuara në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Institucioni.</i> <i>Nëpërmjet mekanizmave stimulus, institucioni nxit përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe promovimin e praktikave më të mira në vlerësimin e performancës së personelit akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në	Statuti dhe aktet e tjera normative përkatëse parashohin mekanizma për sigurimin e cilësisë në institucion. Këto detyrime normative janë materializuar nga ana e institucionit. Fakulteti i Drejtësisë ka politika dhe struktura të qarta për

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

88

përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, të dokumentuara dhe të njohura nga të gjithë aktorët. Ato janë në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 (neni 103), Statutin e UT-së (<i>nenet 138 e vijues</i>) dhe Rregulloren e UT-së (<i>nenet 30-31</i>). Ngritja dhe funksionimi i NJSBC-së është formalizuar me urdhër zyrtar, duke garantuar një sistem të qëndrueshëm dhe transparent për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë. <i>Evidenca 2. Statuti i UT-së;</i> <i>Evidenca 3. Rregullorja e UT-së;</i> <i>Evidenca 33 Urdhër për Ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë;</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Institucioni ka formuar trupa intern për sigurimin e cilësisë. Institucioni zbaton edhe strategjinë për avancim në punën akademike. Fakulteti i Drejtësisë zbaton një sistem të brendshëm për sigurimin e cilësisë në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, Statutin dhe Rregulloren e UT-së. Sistemi i brendshëm i cilësisë siguron cilësinë e mësimdhënies dhe programeve akademike përmes strukturave të dedikuara. Studentët dhe ekspertët kontribuojnë në proceset e vlerësimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm. <i>Evidenca 2. Statuti i UT-së;</i> <i>Evidenca 3. Rregullorja e UT-së;</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Sigurimi i cilësisë realizohet nëpërmjet mekanizmave intern dhe të jashtëm, siç janë procesi i vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm nëpërmjet procesit të akreditimit.
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie	Institucioni përdor tregues të matshëm dhe të qartë sipas standardit kombëtar dhe ndërkombëtar referuar gjendjes reale të procesit akademik në program. Fakulteti i Drejtësisë



dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	monitoron cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit përmes treguesve të qartë dhe të matshëm, duke identifikuar praktikatat e suksesshme për përmirësim të vazhdueshëm. <i>Evidenca nr. 29.10 Procesverbalet e Mbledhjeve të Departamentit;</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ndjek politika të qartë dhe zbaton mekanizma efikas për sigurimin e cilësisë në procesin akademik dhe realizimin e programit.</i> <i>Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve për mësimdhënien në fund të çdo semestri, raportet e vetvlerësimit të personelit akademik, si dhe analizat e ecursisë të realizuara në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Universiteti.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe	Jane hartuar raporte periodike lidhur me mbikëqyrjen e programit në bazë të mekanizmave të përdorur për vlerësimin e cilësisë. Këto raporte janë drejtuar tek autoritetet udhëheqëse të programit. Në nivel institucional struktura përgjegjëse për monitorimin e cilësisë, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të studimit është Drejtoria e Kurrikulave dhe NJSBC. Fakulteti i Drejtësisë ka mekanizma të dokumentuar për shqyrtimin, miratimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të programit të ciklit të dytë, duke vlerësuar arritjet dhe mangësitë si dhe duke promovuar praktikatat më të mira. GVJ konstatoi se ky institucion përdor mekanizma dhe procese

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

90

arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	specifike për granatimin e mbikqyerjes dhe programit të studimit si psh raportet vjetore, pyetësorët që plotësojnë studentët për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies, apo formularët që plotësohen për të deklaruar aktivitetin shkencor që janë zhvilluar gjatë vitit akademik si dhe mbledhjet periodike që zhvillon njësi bazë ku personeli akademik njihet me vlerësimet e pyetësorit. <i>Evidenca nr. 33.4 Raportet Vjetore të Monitorimit të KSBCNJSBC;</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Konstatimet e raporteve të hartuara flasin për përputhshmërinë e objektivave të programit me kërkesat normative përkatëse nacionale. Monitorimi i procesit të përmbushjes së masave në kuadër të gjetjeve të konstatuara realizohet nga NJSBC-ja nëpërmjet monitorimeve të vazhdueshme nga personat përgjegjës, autoritetet drejtuese, nga diskutimet me stafin akademik si dhe pyetësorëve. Në raportet e hartuara evidentohen dhe raportohen çështje si: ✓ Cilësia e materialeve mësimore (literaturës); ✓ Cilësia e performancës së personelit akademik; ✓ Komunikimi pedagog-student; ✓ Konceptimi i transparencës në vlerësim; ✓ Përputhja e materialit lëndor me format dhe mënyrat e vlerësimit; ✓ Raporti teori/ praktikë në kurrikula, etj; <i>Evidenca 33.4 Raportet Vjetore të Monitorimit të KSBCNJSBC;</i> <i>Evidenca 33.5 Rregullore mbi Vlerësimin e Performancës në Punë të Personelit Ndihmës Akademik dhe Administrative në UT;</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të	Si mekanizma për vlerësimin e cilësisë së programit zbatohen dhe përdoren mekanizma, të mirënjohur, direkt; p. sh. vlerësimi i provimeve, vlerësimi i programeve të lëndëve etj. Për stafin akademik përdoret metoda e vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik. GVJ konstatoi se UT ka procedura formale që përdoren për mbikqyrje periodike të programeve të studimit në nivel departamenti mbi baza vjetore dhe semestrale si: - përditësimi dhe miratimi i syllabuseve të lëndëve çdo fillim

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

91



provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	viti akademik; - në fund të çdo semestri, organizohet pyetësori studentor për cilësinë e mësimdhënies; - dosja e vetëvlerësimit bazuar në kërkim shkencorë dhe angazhime akademike - monitorime të procesit mësimor & analiza në mbledhjet e departamentit; <i>Evidenca 33.5 Rregullore mbi Vlerësimin e Performancës në Punë të Personelit Ndihmës Akademik dhe Administrative në UT;</i> <i>Evidenca 33.6 Shembull Performance të Personelit Akademik;</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	Si mekanizma për vlerësimin e cilësisë janë përdorur edhe metoda të tërthorta, siç janë anketat e realizuara me studentë. Institucioni përdor instrumente vlerësues të drejtpërdrejt për didaktikën, kurrikulën, të mësuarit dhe provimeve Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë përdor mekanizma për matjen e cilësisë nëpërmjet pyetsorëve dhe sondazheve dhe intervistave të kryera tek studentët për matjen, vlerësimin dhe cilësinë e programit. Pasi përpunohen dhe analizohen të dhënat e tyre kthehen në formën e raporteve të cila ju vihen në dispozicion strukturave drejtuese dhe personelit akademik. Në këto pyetsorë informacioni që synohet të mbledhet lidhet me: Organizimin e lëndës; Programin e lëndës; Materialet e lëndës; Komponentët e vlerësimit; Pedagogu; Materialet e mësimdhënies; Performanca e klasës. <i>Evidenca 28. Raport Për Alumni-Dega e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni FDUT;</i> <i>Evidenca 33.4 Raportet Vjetore të Monitorimit të KSBCNJSBC;</i>
Konkluzione	<i>Institucioni prodhon raporte me vlerësime periodike mbi vlerësimin e programit, në të cilat konstatohet përputhshmëria e programit me kërkesat përkatëse normative. Në këtë proces merret në konsideratë edhe opinioni i studentëve.</i> <i>Në nivel njësie kryesore bëhen analiza vjetore të punës mësimore dhe kërkimore bazuar në përpunimin e pyetsorëve, formularët e vetëvlerësimit, duke nxjerrë në pah arritjet dhe</i>



	<i>rekomandimet për të ardhmen.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare janë të përfshira në aktivitete të ndryshme lidhur me institucionin dhe kjo përbën vlerës të shtuar. Institucioni siguron angazhimin e një gamë të gjerë aktorësh në procesin e vlerësimit të cilësisë dhe aksesin e kontributeve të tyre. Universiteti i Tiranës ka ngritur një sistem efikas me struktura të brendshme për sigurimin e cilësisë, ku përfshihen personeli akademik, ndihmës-administrativ dhe studentët. Pjesëmarrja e tyre realizohet edhe përmes mekanizmave dhe metodave të tërthorta të vlerësimit, që lejojnë përfshirjen dhe marrjen e opinionit mbi cilësinë e programeve të studimit. <i>Evidenca 33.4 Raportet Vjetore të Monitorimit të KSBCNJSBC;</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Me akte interne përkatëse normative janë paraparë edhe struktura të ndryshme përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Fakulteti i Drejtësisë përfshin strukturat akademike, ndihmës-akademike, administrative dhe studentët në procesin e vlerësimit të cilësisë, sipas strategjive institucionale dhe rregulloreve të brendshme. Detyrat e NJSBC si struktura kryesore e sigurimit të cilësisë janë të përcaktuara qartë në rregulloren e saj. Duke qenë se pyetësorët janë anonim, studentët mund të shprehin lirshëm dhe në mënyrë sa më objektive mendimet e tyre mbi procesin mësimor. <i>Evidenca 33.4 Raportet Vjetore të Monitorimit të KSBCNJSBC;</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore,	Me aktet interne normative të Institucionit parashikohen të drejtat, por edhe detyrimet e njësisë bazë, personelit akademik dhe joakademik si dhe subjekteve të tjera institucionale në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. UT ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila ka

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.asc.al

93

përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	për detyrë monitorimin në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore. Në vlerësimin e sigurimit të cilësisë së programit të studimit garantohej përfshirja e personelit akademik nga Departamentet e Fakultetit, stafit ndihmës administrativ dhe studentët. <i>Evidenca 29.10 Procesverbalet e Mbledhjeve të Departamentit;</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Institucioni ka parashikuar norma përkatëse për kredibilitetin e procesit të vlerësimit duke përjashtuar çfarëdo diskriminimi apo trajtim jo të barabartë të personelit. Përfshirja e të gjithë aktorëve të brendshëm në vlerësimin e cilësisë bëhet në përputhje me parimet e integritetit akademik, barazisë dhe ndalimit të diskriminimit. Aktet regullatore të brendshme përcaktojnë procedura që garantojnë respektimin e këtyre parimeve, duke përfshirë stafin akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ, dhe duke shmangur çdo formë diskriminimi apo pabarazie. <i>Evidenca 15. Rregullorja e Programit të Studimi të Integruar të Ciklit të Dytë në Drejtësi;</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Institucioni angazhon edhe akterë të tjerë të jashtëm në procese të vlerësimit dhe sigurimit të vlerësimit të brendshëm. Proceset e vlerësimit të programit të studimit përfshijnë në diskutime edhe bashkëpunëtorët e Departamentit, të angazhuar si staf akademik i jashtëm, apo të atyre që monitorojnë praktikën e studentëve, të cilët janë përfaqësues të institucioneve partnere, apo ish student alumni. Ky bashkëpunim, së bashku me angazhimin e stafit akademik dhe studentëve në vetëvlerësim, garanton funksionimin efektiv të sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë, sipas nenit 139 të Statutit të UT-së. <i>Evidenca 2. Statuti i UT-së;</i>
Konkluzione	<i>Institucioni ka marrë masa në përfshirjen e akterëve të brendshëm dhe të të jashtëm në proceset e sigurimit të cilësisë së programit.</i> <i>Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Drejtësisë, përmes politikave të sigurimit të cilësisë, mundësojnë angazhimin dhe aksesin e kontributeve të aktorëve të ndryshëm në procesin e vlerësimit të cilësisë.</i> <i>Në aktet e brendshme përcaktohen detyra dhe përgjegjësi</i>

	konkrete për secilin aktor të përfshirë. Përfshirja realizohet në përputhje me parimet e integritetit akademik, barazisë dhe ndalimit të diskriminimit. Në këtë proces marrin pjesë edhe bashkëpunëtorët e jashtëm, të cilët me ekspertizën e tyre ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Veprimtaria vlerësuese planifikohet në kohë periodike njëvjeçare, gjatë të së cilës edhe ndërmerret aktiviteti i vlerësimit. Ky aktivitet është publik edhe për studentët. Politikat dhe strategjitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë publike dhe të aksesueshme për studentët dhe palët e interesuara përmes platformave online dhe dokumenteve zyrtare. Të gjitha proceset dhe aktivitetet e cilësisë zhvillohen në mënyrë transparente dhe janë të hapura për të gjithë të interesuarit. <i>Evidenca 33.4 Raportet Vjetore të Monitorimit të KSBCNJSBC;</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Raportet e vlerësimit publikohen, kurse raportet e veçanta iu komunikohen veçanërisht personelit akademik. GVJ konstaton se Fakulteti i Drejtësisë zbaton praktika etike në publikimin e rezultateve të vlerësimeve, duke respektuar konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale sipas Statutit, Rregullores së UT-së dhe Ligjit Nr. 80/2015. Rezultatet janë publike dhe të aksesueshme për të gjithë, duke ruajtur lirinë akademike dhe standardet ligjore. <i>Evidenca 3. Rregullorja e UT-së;</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe	Me rezultate shoqërohen edhe gjetjet si dhe masat për adresimin e të gjeturave. GVJ konstaton se Fakulteti i Drejtësisë ka strukturë dhe mekanizma të qartë për sigurimin e cilësisë, duke përfshirë

synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	monitorimin e vazhdueshëm, pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe stafit, si dhe zbatimin e planeve konkrete për përmirësim të programeve akademike. <i>Evidenca 5.1. Strategjia e Zhvillimit të UT-së 2023-2028;</i> <i>Evidenca 33.4 Raportet Vjetore të Monitorimit të KSBCNJSBC;</i>			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Konstatimet e rezultateve dhe të dhënat e publikuara përdoren për avancimin e punës akademike, adresimin e të gjeturave dhe përmirësimin e situatës akademike në përgjithësi. Fakulteti i Drejtësisë zbaton një proces të rregullt monitorimi dhe vlerësimi për të siguruar efektivitetin dhe ndikimin pozitiv të aktiviteteve në cilësinë e programeve, në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore. <i>Evidenca 33.4 Raportet Vjetore të Monitorimit të KSBCNJSBC;</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Fakulteti i Drejtësisë dhe UT zhvillojnë trajnime dhe takime për të informuar dhe ndërgjegjësuar studentët e stafin mbi rëndësinë e sigurimit të cilësisë, duke ndihmuar në ndërtimin e një kulture të qëndrueshme për përmirësimin afatgjatë të cilësisë. <i>Evidenca 33.5 Rregullore mbi Vlerësimin e Performancës në Punë të Personelit Ndihmës Akademik dhe Administrative në UT;</i>			
Konkluzione	<i>Raportet lidhur me veprimtarinë vlerësuese janë periodike. Ato shërbejnë për të pasur një pasqyrë më të qartë për performancën e personelit dhe për të avancuar punën akademike dhe profesionale në institucion.</i> <i>Kuadri rregullator i institucionit parashikon publikimin në faqen eeb të tij, të të gjitha veprimtarive përfshirë edhe ato për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel universiteti, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të vlerësimit të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Drejtësi"

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi mbështetet në përvojën e gjatë dhe autoritetin profesional të Fakultetit të Drejtësisë së UT-së, i cili njihet gjerësisht si një nga institucionet më të rëndësishme të arsimit juridik në vend;
2. Anëtarët e personelit akademik janë ekspertë të njohur në fushën e së drejtës, me angazhim të vazhdueshëm në projekte kërkimore dhe bashkëpunime me institucione gjyqësore, universitete të huaja dhe organizata ndërkombëtare duke garantuar cilësinë e mësimdhënies dhe e lidh programin me realitetin profesional;
3. Stafi akademik ndjek rregullisht trajnime mbi metodat moderne dhe të digjitalizuara të mësimdhënies, duke përmirësuar cilësinë e përçimit të njohurive dhe ndërveprimin me studentët;
4. Procesi mësimor zhvillohet në ambiente funksionale dhe të pajisura sipas standardeve bashkëkohore. Studentët dhe stafi kanë akses në biblioteka të pasura, databaza shkencore ndërkombëtare dhe platforma digjitale që mbështesin mësimdhënien dhe kërkimin;
5. Programi mbështetet në përvojën dhe reputacionin e gjatë të Fakultetit të Drejtësisë të UT-së si një ndër më të rëndësishmit të arsimit juridik në vend;
6. Programi ofron një formim të thelluar dhe të balancuar në të drejtën kombëtare dhe ndërkombëtare, duke u mbështetur në një qasje akademike moderne që harmonizohet me zhvillimet më të fundit në arsimin juridik evropian. Ndërkombëtarizimi është një komponent integral i strategjisë së institucionit, i cili synon rritjen e konkurrueshmërisë së diplomantëve në tregjet ndërkombëtare dhe forcimin e bashkëpunimit me universitete dhe institucione të huaja;
7. Struktura e programit përfshin të gjitha fushat themelore të së drejtës, me theks të veçantë në përgatitjen praktike dhe aftësitë e interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Përmbajtja akademike është fleksibile dhe rishikohet rregullisht në funksion të zhvillimeve ligjore dhe nevojave të tregut;
8. Institucioni ofron mbështetje ndaj stafit dhe studentëve për pjesëmarrjen në konferenca, publikimin e artikujve dhe përfshirjen në projekte kërkimore, duke nxitur kulturën kërkimore në nivel akademik;
9. Studentët përfshihen në klinikën ligjore dhe në aktivitete praktike që kontribuojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e aftësive të tyre profesionale dhe në përgatitjen për tregun e punës;

b. Pikat e dobta:



1. Fakulteti ende nuk ka krijuar një sistem të strukturuar dhe formal për monitorimin e karrierës së të diplomuarve dhe për analizën e ndikimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit që lidhen me programin; *(Standardi I.2, Kriteri 4)*
2. Në procesin mësimdhënës të këtij program studimi konstatohet personel akademik me (MSc), ndërkohë që kërkohet që stafi akademik të ketë të paktën gradë shkencore (Dr), sipas parashikimit të nenit 59/6 të Ligjit nr. 80/2015 ku përcaktohet niveli i kualifikimit akademik; *(Standardi IV.1, Kriteri 1)*

c. Rekomandime

1. GVJ rekomandon që Fakulteti i Drejtësisë të institucionalizojë hartimin periodik të raporteve analitike që matin ndikimin e bashkëpunimeve në cilësinë e programeve të studimit; të zgjerojë dhe shfrytëzojë më mirë marrëveshjet ekzistuese ndërinstitucionale, të rrisë pjesëmarrjen në projekte e bashkëpunime ndërkombëtare me synim ndërkombëtarizimin e programit të studimit Master i Shkencave në Drejtësi dhe mobilitetin e studentëve e stafit akademik dhe administrativ;
2. GVJ rekomandon që Fakulteti i Drejtësisë të përmbyllë dhe të miratojë sa më parë rregulloret e brendshme për mbarvajtjen dhe mbështetjen e veprimtarisë konform ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe statutit të UT;
3. GVJ rekomandon që Fakulteti i Drejtësisë të ndërtojë dhe institucionalizojë një sistem të strukturuar dhe formal për ndjekjen e karrierës së të diplomuarve, si dhe për analizën e ndikimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit që lidhen me programin e studimit Master i Shkencave në Drejtësi;
4. GVJ rekomandon që Fakulteti i Drejtësisë të sigurojë plotësimin e kërkesave ligjore për mësimdhënien nga stafi akademik, duke përsheptuar angazhimin e personelit vetëm me gradë shkencore "Dr" në mësimdhënie të programit të ciklit të dytë;
5. GVJ rekomandon që Fakulteti të sigurojë zbatimin e orarit të zgjatur të sallës së leximit në bibliotekë, duke synuar akses të plotë për studentët dhe stafin akademik në orarin 08:00–20:00;

Conclusions of the Evaluation of the Integrated Second Cycle Study Program "Master of Science in Law"

a. Strengths and Affirmative Aspects

1. The program is supported by the long-standing experience and professional authority of the Faculty of Law at the University of Tirana, widely recognized as one of the leading institutions of legal education in the country.
2. Academic staff members are recognized experts in the field of law, with continuous engagement in research projects and collaborations with judicial institutions, foreign universities, and international organizations, ensuring high-quality teaching and alignment with professional realities.
3. Academic staff regularly participates in training on modern and digitalized teaching methods, enhancing the quality of knowledge delivery and interaction with students.
4. Teaching takes place in functional and well-equipped facilities that meet contemporary standards. Students and staff have access to rich libraries, international scientific databases, and digital platforms that support teaching and research.
5. The program builds on the long-standing reputation and experience of the Faculty of Law at UT as one of the leading law schools in Albania.
6. The program offers in-depth and balanced training in national and international law, based on a modern academic approach aligned with recent developments in European legal education. Internationalization is an integral component of the institution's strategy, aiming to enhance the global competitiveness of graduates and strengthen cooperation with foreign universities and institutions.
7. The program's structure covers all core areas of law, with particular focus on practical training and skills in legal interpretation and application. Its academic content is flexible and reviewed regularly in accordance with legal developments and labor market needs.
8. The institution supports both staff and students in participating in conferences, publishing research articles, and engaging in research projects, thus fostering an academic research culture.
9. Students are actively involved in the legal clinic and other practical activities that directly contribute to the development of their professional skills and their preparation for the labor market.

b. Weaknesses:

1. The Faculty has not yet established a structured and formal system for tracking graduate careers and analyzing the impact of cooperation agreements related to the study program.
(Standard I.2, Criterion 4)



2. In the teaching process of this study program, academic staff holding only an MSc degree have been identified, while it is required that academic staff hold at least a doctoral degree (PhD), in accordance with Article 59/6 of Law no. 80/2015, which sets the level of academic qualification; (*Standard IV.1, Criterion 1*).

c. Recommendations

1. The External Evaluation Group recommends that the Faculty of Law institutionalize the periodic preparation of analytical reports that measure the impact of cooperation on the quality of study programs; enhance and better utilize existing inter-institutional agreements; and increase participation in international projects and collaborations with the aim of internationalizing the "Master of Science in Law" program and promoting mobility for students, academic, and administrative staff.
2. The External Evaluation Group recommends that the Faculty of Law finalize and formally approve the internal regulations for the functioning and support of its academic activity, in accordance with Law no. 80/2015 "On Higher Education and Scientific Research in Higher Education Institutions in the Republic of Albania" and the Statute of the University of Tirana.
3. The External Evaluation Group recommends that the Faculty of Law develop and institutionalize a structured and formal system for tracking graduates' career paths and analyzing the impact of cooperation agreements related to the "Master of Science in Law" program.
4. The External Evaluation Group recommends that the Faculty of Law ensure compliance with legal requirements for teaching staff by accelerating the recruitment of personnel holding the "Doctor" degree, thus avoiding the engagement of staff with only a "Master of Science" in second cycle programs.
5. The External Evaluation Group recommends that the Faculty ensure the implementation of extended reading room hours at the library, aiming to provide full access for students and academic staff from 08:00 to 20:00.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

